



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE
DEPARTAMENTI I INXHINIERISË FIZIKE

DISERTACION

Për mbrojtjen e Gradës Shkencore
“DOKTOR”

**Studimi i vetive fizike të sistemit katërsh methyl *tert*-butyl ether +
n-heksan + cikloheksan + benzen dhe nënsistemeve të tij dyshe
dhe treshe në temperaturë $T = (293.15, 298.15, \text{dhe } 303.15) \text{ K}$ dhe
shtypje lokale atmosferike**

Fusha: Inxhinieri Fizike

Kandidati

MSc. Artan LLOZANA

Udhëheqës Shkencor

Prof. Asoc. Dr. Altin GJEVORI

Tiranë, 2025



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE
DEPARTAMENTI I INXHINIERISË FIZIKE

DISERTACION

Për mbrojtjen e Gradës Shkencore
“DOKTOR”

**Studimi i vetive fizike të sistemit katërsh methyl *tert*-butyl ether +
n-heksan + cikloheksan + benzen dhe nënsistemeve të tij dyshe
dhe treshe në temperaturë $T = (293.15, 298.15, \text{dhe } 303.15) \text{ K}$ dhe
shtypje lokale atmosferike**

Përgatitur nga:

MSc. Artan LLOZANA

Udhëheqës Shkencor

Prof. Asoc. Dr. Altin GJEVORI

Tiranë, 2025



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE
DEPARTAMENTI I INXHINIERISË FIZIKE

DISERTACION

I paraqitur nga:
MSc. Artan LLOZANA

Për fitimin e Gradës Shkencore
“DOKTOR”

Në Inxhinieri Fizike

Tema:

Studimi i vetive fizike të sistemit katërsh methyl *tert*-butyl ether + *n*-heksan + cikloheksan + benzen dhe nënsistemeve të tij dyshe dhe treshe në temperaturë $T = (293.15, 298.15, \text{dhe } 303.15) \text{ K}$ dhe shtypje lokale atmosferike

Mbrohet më datë ____/____/2025 para Jurisë, e miratuar nga KP i FIMIF me Vendimin Nr.____, datë ____/____/2025.

- | | |
|---------|------------------|
| 1. | Kryetar |
| 2. | Anëtar (oponent) |
| 3. | Anëtar (oponent) |
| 4. | Anëtar |
| 5. | Anëtar |

Deklaratë mbi Origjinalitetin e Punimit

Unë, i nënshkruari Artan LLOZANA, deklaroj se jam autor i disertacionit, për fitimin e gradës shkencore ” Doktor”, me temë :

“Studimi i vetive fizike të sistemit katërsh methyl *tert*-butyl ether + *n*-heksan + cikloheksan + benzen dhe nënsistemeve të tij dyshe dhe treshe në temperaturë $T = (293.15, 298.15, \text{ dhe } 303.15) \text{ K}$ dhe shtypje lokale atmosferike”

Deklaroj në përgjegjësinë time personale, se disertacioni është një punim origjinal dhe në përputhje me rregullat akademike dhe etikën profesionale. Në punim përfshirja e informacionit të marrë nga literatura është kryer në përputhje të plotë me parimet e antiplagjaturës, duke cituar me përpikmëri çdo referim.

Autori

Artan Llozana

PËRMBAJTJA:

I. HYRJE.....	- 3 -
2. PJESA TEORIKE	- 6 -
2.1. VETITË TERMODINAMIKE	- 6 -
2.1.1. Densiteti	- 6 -
2.1.2. Shpejtësia e zërit	- 8 -
2.1.3. Indeksi i thyerjes	- 8 -
2.2. VETITË TERMODINAMIKE SHITESË.....	- 9 -
2.2.1. Vëllimi molar shitesë.....	- 9 -
2.2.2. Ngjeshmëriaizentropik shitesë	- 11 -
2.2.3. Devijimi në indeks të thyerjes.....	- 11 -
2.3. KORELIMI DHE PARASHIKIMI I VETIVE SHITESË	- 12 -
2.4 . VLERËSIMI I PAPERCAKTUESHMËRIVE NË MATJE	- 13 -
3. PJESA EKSPERIMENTALE	- 16 -
3.1. SUBSTANCAT E PËRZGJEDHURA PËR KËTË HULUMTIM	- 16 -
3.3.1. Tert-butili metil eteri (MTBE).....	- 17 -
3.3.2. n-heksani	- 17 -
3.3.3. Cikloheksani.....	- 18 -
3.3.4. Benzeni	- 18 -
3.2. MATJA E DENSITETIT DHE SHPEJTËSISË ULTRASONIKE	- 21 -
3.3. MATJA E INDEKSIT TË THYERJES.....	- 23 -
4. REZULTATET DHE DISKUTIMET E MATJEVE EKSPERIMENTALE	- 25 -
4.1. REZULTATET EKPERIMENTALE PËR SISTEMET DYSHE.....	- 25 -
4.1.1. Vëllimi molar shitesë.....	- 25 -
4.1.2. Ngjeshmëriaizentropik shitesë	- 28 -
4.1.3. Devijimi në indeks të thyerjes.....	- 31 -
4.2. KRAHASIMI I SISTEMEVE DYSHE ME LITERATUREN	- 32 -
4.2.1. Vëllimi molar shitesë.....	- 32 -
4.2.2. Ngjeshmëriaizentropik shitesë	- 35 -
4.2.3. Devijimet në indeksin e thyerjes	- 37 -
4.3. SISTEMET TRESHE	- 39 -
4.4. SISTEMI KATËRSH.....	- 46 -
5 KORELIMI I VETIVE TEMODINAMIKE DUKE PËRDORUR MODELIN JOUYBAN – ACREE	- 47 -
5.1. KORELIMI I VETIVE TERMODINAMIKE TË SISTEMEVE DYSHE	- 47 -
5.1.1. Korelimi i densitetit (ρ)	- 47 -
5.1.2. Korelimi i shpejtësisë së zërit (u)	- 49 -
5.1.3. Korelimi i koeficientit të zgjerimit (α)	- 51 -
5.1.4. Korelimi i kompresibilitetit izentropik (κ_S)	- 53 -
5.2. KORELIMI I VETIVE TERMODINAMIKE TË SISTEMEVE TRESHE	- 55 -
5.2.1. Korelimi i densitetit (ρ)	- 56 -
5.2.2. Korelimi i shpejtësisë së zërit (u).....	- 57 -
5.2.3. Korelimi i koeficientit të zgjerimit (α)	- 58 -
5.2.4. Korelimi i kompresibilitetit izentropik (κ_S)	- 59 -
5.3. KORELIMI I VETIVE TERMODINAMIKE TË SISTEMIT KATËRSH	- 60 -

6. PARASHIKIMI I VETIVE TERMOFIZIKE SHITESË DUKE PËRDORUR MODELET GJEOMETRIKE	- 63 -
6.1. PARASHIKIMI I VETIVE TERMOFIZIKE SHITESË PËR SISTEMET TRESHE	- 63 -
6.2. PARASHIKIMI I VETIVE TERMOFIZIKE SHITESË PËR SISTEM KATËRSH	- 79 -
PËRFUNDIME	- 88 -
Lista e figurave	- 91 -
Lista e tabelave	- 95 -
REFERENCAT	- 99 -
Shtojca.....	- 103 -

I. HYRJE

Studimi i sistemeve me shumëkomponente ka një rëndësi të veçantë në inxhinierinë kimike, kimi fizike dhe aplikimet të ndryshme industriale, pasi këto sisteme janë të rëndësishme në shumë procese që ndodhin në industrinë kimike, atë të energjisë dhe në teknologjitë e përpunimit të materialeve. Një sistem me shumëkomponente përfshin më shumë se dy komponente, dhe këto sisteme shpesh janë të ndërlikuara për shkak të bashkëveprimeve të ndryshme që ndodhin mes komponenteve, të cilat mund të ndikojnë në mënyra të ndryshme në vetitë fizike dhe termodinamike të sistemit në përgjithësi. Një nga aspektet më interesante dhe më të rëndësishme të studimit të këtyre sistemeve është analiza e vetive fizike të tyre, siç janë densiteti, shpejtësia e zerit, indeksi i thyrejes dhe vetitë e tjera që lidhen me shkrirjen, avullimin dhe bashkëveprimet ndërmjet përbërësve në temperatura të ndryshme. Përdorimi i këtyre sistemeve është i zakonshëm në aplikime të ndryshme, përfshirë distilimin, ekstraktimin dhe përpunimin e materialeve, duke u kërkuar që të kuptojmë më mirë se si ndryshimet në përqindje të komponimeve ndikojnë në vetitë e mësipërme.

Duke shfletuar literaturën kemi vërejtur se ky sistem nuk është i hulumtuar dhe kjo ishte njëra nga arsyet që ky sistem ka tërhequr vëmendjen tonë të studimit pra sistemi MTBE (metil tert-butil eter), *n*-heksan, cikloheksan dhe benzen. Megjithatë janë disa studime që përfshijnë komponime organike të sistemit dyshe të këtij sistemi katërsht [1], [2], [3], [4], [5], [6], [7] dhe [8]. Ky sistem ka një rëndësi të veçantë për shkak të aplikimeve të tij të gjera në industrinë e karburanteve [9], [10] dhe [11] si dhe për shkak të mundësisë për të studiuar ndërveprimin e përbërësve polarë dhe jo-polarë. MTBE është një komponim që përdoret kryesisht si aditiv për karburante, pasi ai ndihmon në rritjen e oktanit dhe përmirëson cilësinë e karburanteve [12], [13], MTBE në veçanti, i vetëm ose i përzier me alkanole, redukton ndjeshëm emetimin e CO₂ dhe hidrokarbureve nga motorët e automjeteve [12], [13], [14], [15]. *n*-heksani dhe cikloheksani janë hidrokarbure të përdorura si tretës dhe si lëndë të para për prodhimin e kimikateve të tjera, ndërsa benzeni është një komponim që përdoret gjerësisht në industrinë kimike dhe farmaceutike, por gjithashtu është i njohur për rrezikshmërinë e tij për shëndetin njerëzor. Studimi i këtyre përbërësve dhe mënyrës se si ata bashkëveprojnë në kushte të ndryshme është një hap i parë i rëndësishëm për të kuptuar sjelljen e sistemit në përgjithësi dhe për të zhvilluar metoda të sakta dhe efikase për optimizimin e proceseve që përfshijnë këto komponime.

Një aspekt i rëndësishëm i studimit të sistemeve me shumëkomponente është analiza e nën-sistemeve të tyre, të cilat mund të jenë dyshe ose treshe. Një sistem dysh përbëhet nga dy komponente, dhe analiza e tij mund të ndihmojë në kuptimin e bashkëveprimeve që ndodhin ndërmjet këtyre komponimeve. Meqenëse shumë sisteme me shumë-komponente përbëhen nga disa komponentë, shpesh është më e lehtë të studiohet sjellja e tyre duke analizuar nën-sistemet dyshe dhe treshe, të cilat ndihmojnë në thjeshtimin e studimit të sjelljes së tyre. Sistemet treshe përfshijnë tri komponente dhe ndihmojnë në analizën më të hollësishme të bashkëveprimeve që ndodhin kur kemi bashkëveprime molekulare mes tre komponimeve. Për sistemin tonë, nën – sistemet dyshe do të përfshijnë MTBE (1) + n – heksan (2), MTBE (1) + cikloheksan (3), MTBE (1) + benzen (4), n – heksan (2) + cikloheksan (3), n – heksan (2) + benzen (4), cikloheksan (3) + benzen (4), ndërsa nën – sistemet treshe do të përfshijnë MTBE (1) + n – heksan (2) + cikloheksan (3), MTBE (1) + n – heksan (2) + benzen (4), MTBE (1) + cikloheksan (3) + benzen (4) dhe n – heksan (2) + cikloheksan (3) + benzen (4) dhe sistemi katërshe është MTBE (1) + n – heksan (2) + cikloheksan (3) + benzen (4). Ky studim i nën-sistemeve është thelbësor për të kuptuar se si të parashikohet sjellja e përbërësve në kushte të ndryshme dhe si këto ndikojnë në vetitë fizike të sistemit me shumëkomponente. Përcaktimi eksperimental i vetive termodinamike dhe termofizike të lëngjeve dhe përzierjeve të tyre, si dhe zhvillimi i modeleve për korelacionin, parashikimin dhe ndërlidhjen e tyre përfaqësojnë fushat aktuale të kërkimit dhe ofrojnë informacionin e nevojshëm për projektimin e shumë proceseve dhe pajisjeve industriale [16], [17].

Një nga pyetjet kyçe që lind kur studiohen sisteme të tilla është se si mund të parashikohet sjellja e një sistemi të tillë në kushte që ndodhin në praktikë. Kjo është shumë e rëndësishme në analizën e sistemeve me shumëkomponente, dhe për këtë arsye, përdorimi i modeleve matematikore dhe gjeometrike është një metodë shumë e përdorur dhe efektive për të parashikuar sjelljen e sistemeve të tilla. Modelet matematikore përdoren për të zhvilluar ekuacione që mund të parashikojnë sjelljen e sistemeve në kushte të ndryshme dhe ndihmojnë në optimizimin e procesit të përpunimit të materialeve. Janë përdorur modele koreluese dhe parashikuese, koreluese si modeli Jouyban – Acree, ky model është përdorur për të koreluar vetitë termodinamike dhe si modele parashikuese janë përdorur modelet simetrike Kohler dhe Muggianu dhe si modele asimetrike Toop dhe Hillert. Përdorimi i modeleve matematikore dhe gjeometrike për të parashikuar vetitë e sistemit MTBE + n -heksan + cikloheksan + benzen është një pjesë e rëndësishme e këtij studimi. Këto modele përdorin marrëdhënie gjeometrike që mundësojnë parashikimin e sjelljes së sistemit bazuar në vetitë e përbërësve të sistemit dhe

bashkëveprimet në mes tyre. Modelet matematikore mund të ofrojnë një mënyrë të saktë dhe të shpejtë për të parashikuar sjelljen e sistemeve me shumëkomponente në kushte të ndryshme.

Për të vlerësuar saktësinë e modeleve të përdorura, është e nevojshme të krahasohen rezultatet e parashikuara me të dhënat eksperimentale. Ky krahasim ndihmon për të kuptuar se sa mirë modelet mund të përshkruajnë sjelljen e sistemit dhe si mund të përshtaten ato për të përmirësuar saktësinë e parashikimeve të ardhshme.

Një nga aspektet më të rëndësishme të studimit të sistemeve me shumëkomponente është ndikimi i temperaturës mbi vetitë fizike dhe termodinamikë të këtyre sistemeve. Ky variabël është shumë i rëndësishëm për të kuptuar sjelljen e çdo lëngu dhe mund të ndihmojnë në parashikimin e formimit të fazave, si dhe të ndërveprimeve mes përbërësve në sistemin me shumëkomponente. Studimi i temperaturës është thelbësor, sepse ndryshimi i saj mund të ndikojë në shkrirjen e përbërësve, në avullimin e tyre, si dhe në formimin e fazave të ndryshme të sistemit. Përdorimi i kushteve të ndryshme të temperaturës mund të ndihmojë në përcaktimin e përbërjeve optimale për një proces të caktuar dhe mund të kontribuojë në parashikimin e sjelljes së sistemit gjatë proceseve si distilimi, filtrimi, ose trajtimi i lëngjeve.

2. PJESA TEORIKE

2.1. VETITË TERMODINAMIKE

Vetitë termodinamike, siç janë densiteti, shpejtësia e zërit, indeksi i thyerjes dhe vetitë termodinamike të derivuara, përfshirë vëllimin shtesë, entalpinë molare shtesë, kompresibilitetin izotropik, kompresibilitetin izotermik, energjinë shtesë të Gibbs-it, kapacitetin termik izobarik dhe izohorik, kanë një rëndësi të madhe. Këto veti janë thelbësore për një sërë procesesh industriale, veçanërisht në industritë e naftës dhe gazit natyror, industrinë kimike, farmaceutike, të tekstilit, letrës dhe në sektorë të ndryshëm kimikë. Studimi i vetive termodinamike është i domosdoshëm për të kuptuar bashkëveprimet molekulare, natyrën dhe forcën e tyre, si dhe paketimin molekular midis lëngjeve të pastra dhe në një përzierje. Ato analizohen në varësi të përbërjes, kryesisht raportit molar, dhe temperaturës ose në rang të temperaturave.

2.1.1. Densiteti

Densiteti është ndër vetitë fizike më të rëndësishme të lëngjeve dhe jo vetem. Njohja e vlerave të tij për lëngjet e ndryshme ka zbatim të madh për shumë fusha. Densiteti gjenë përdorim për identifikimin e substanca të reja e të pastra, karakterizimin dhe vlerësimin termofizik të lëngjeve dhe të përzierjeve. Densiteti mund të përkufizohet si masa e ndonjë substance në njësi të vëllimit në një temperaturë të caktuar dhe matematikisht shprehet:

$$\rho = \frac{m}{V}$$

ku ρ paraqet densitetin, m masën dhe V vëllimin.

Densiteti tregon se sa është e pakeluar me masë një hapësirë tre-dimensionale e caktuar e ndonjë substance. Kjo nënkupton se sa më shumë që është i pakeluar një trup me masë të caktuar do të rezultojë në afrim më të madh ndërmjet atomeve e kështu edhe në densitet më të madh. Densiteti është madhësi skalare dhe sipas sistemit ndërkombëtar të njësive jepet në njësitë g/cm^3 apo kg/m^3 . Nga densiteti mund të derivohen edhe madhësi të tjera termodinamike si vëllimi molar shtesë, apo edhe me anë të kombinimit të densitetit dhe madhësive të tjera

fizike me shpejtësi të zërit mund të derivohet edhe ngjeshmëria izentropike, kompresibiliteti izentropik shtesë.

Për matjen e densitetit janë përdorur disa metoda si: matje me densimetra me gyp vibrues, metoda Buoyancy, metoda me piknometër etj [18].

Matje e densitetit me gyp vibrues si ide erdhi nga Kratky me bashkëpunëtorë dhe bazohet kryesisht në matjen e densitetit të mostrave në mënyrë indirekte me anë të gypave vibrues. Gypat vibrues bëjnë matjen e periodës së vibrimit rezonues nga e cila llogaritet densiteti si rrjedhojë e lidhjes së ngushtë me te e që matematikisht shprehet:

$$\rho = A + B\tau^2$$

ku A dhe B janë konstante të instrumentit për secilin oshilator individual që tregojnë për elasticitetin, strukturën dhe masën e gypit matës.

Janë të njohura disa mënyra të vibrimit harmonik dhe disa mënyra për matjen e periodës së vibrimit. E përbashkëta e tyre është mjeti që e shkakton vibrimin dhe mjeti për realizimin e matjes.

Matja e densitetit me metodën Buoyancy ka përparësi të madhe në përcaktimin e densitetit sepse ka ndjeshmëri të madhe deri në 10^{-6} e madhësisë së densitetit. Kur një trup me masë m zhytet në një lëng atëherë mbi të do veprojë një forcë shtytëse nga poshtë - lartë. Kjo forcë është në përpjesëtim të drejtë me masën e lëngut të zhvendosur nga ana e këtij trupi të zhytur. Densiteti llogaritet me anë të formulës:

$$\rho = \frac{m_t^* - m_t}{V_t}$$

Ku m_t paraqet masën e dukshme të trupit të zhytur në lëng dhe V_t paraqet vëllimin e lëngut të zhvendosur nga trupi.

Piknometria bazohet në përdorimin e enëve të qelqit, të cilat kanë vëllime relativisht të vogla, të pajisura me gype kapilare në krye të tyre që njihen si piknometra. Piknometri është i pajisur me një tapë të veçantë, e cila largon lëngun e tepërt nga kapilarja. Fillimisht, me peshore analitike matet masa e enës së zbrazët, pastaj, mbushet ena me një lëng me densitet të njohur (p.sh. ujë) për të përcaktuar vëllimin e enës, duke matur masën e ujit. E njëjta gjë përsëritet edhe për piknometrin e mbushur me lëng të njohur (matet masa). Nga masa e piknometrit, gjendet masa e ujit duke bërë zbritjen e masës së enës së mbushur me ujë me masën e piknometrit të

zbrazët. Pastaj kjo procedurë përsëritet prapë me lëngun për të cilin dëshirojmë të masim densitetin. Për llogaritjen e densitetit të lëngut të panjohur përdoret shprehja:

$$\rho_{i \text{ panjohur}} = \frac{m_{e \text{ panjohur}}}{m_{H_2O}} \rho_{H_2O}$$

2.1.2. Shpejtësia e zërit

Zëri në lëngje udhëton në formë të valëve. Vala e zërit është thjesht një valë mekanike gjatësore dhe sikurse valët e tjera karakterizohet nga frekuenca, gjatësia valore dhe shpejtësia. Shpejtësia e zërit është vetia më e rëndësishme termodinamike që bën pjesë në fushën e akustikës. Vala e zërit paraqet një numër të madh të grimcave, të cilat së bashku përbëjnë pulse të presionit dhe i shtyjnë të oshilojnë grimcat e mjedisit paralelisht me drejtimin e përhapjes së valës. Kjo shtyrje e grimcave të mjedisit nga energjia e valës paraqet një lloj ngjeshmërie dhe që nga kjo veti vala e zërit quhet ndryshe edhe si zë kompresues ose gjatësor. Shpejtësia e zërit dallon nga një mjedis në tjetrin. Përhapja e valës së zërit është e ndryshme për gjendjet agregate të ndryshme.

Shpejtësia e zërit ka rëndësi të madhe në studimin e natyrës fizike të bashkëveprimeve molekulare të përzierjeve të lëngjeve apo lëngjeve të pastra. Gjithashtu me anë të shpejtësisë së zërit mund të studiojmë edhe forcën e këtyre bashkëveprimeve molekulare. Shpejtësia e zërit ka rëndësi në termodinamikë për të derivuar vetitë të ndryshme si kompresibilitetin izentropik shtesë dhe atë izotermik, koeficientin e zgjerimit termik izobarik, koeficientin e presionit termik, koeficientin e Xhul-Tomsonit etj.

2.1.3. Indeksi i thyerjes

Indeksi i thyerjes është madhësi fizike, themelore për materialet, që përshkruan se si drita përhapet nëpër materiale të ndryshme. Pra, mund të përkufizohet si raporti i shpejtësisë së një valë qoftë drita ose zëri në vakum ndaj shpejtësisë së fazës në mjedis. Indeksi i thyerjes varet nga gjatësia valore së dritës, kjo mund të shprehet me ekuacionin e mëposhtëm:

$$n = \sqrt{\epsilon_r \mu_r}$$

ku n paraqet indeksin e thyerjes, ε_r paraqet permitivitetin relativ të mjedisit dhe μ_r paraqet permeabilitetin relativ të mjedisit.

2.2. VETITË TERMODINAMIKE SHITESË

2.2.1. Vëllimi molar shtesë

Dihet se përzierjet e lëngjëve të ndryshme japin vlera tjera nga sjellja ideale që janë rezultat i bashkëveprimeve molekulare qofshin të forta apo të dobëta. Vetitë termodinamike shtesë që paraqiten si Y^E në mënyrë kualitative dhe kuantitative tregojnë për devijimet nga sjellja ideale tek përzierjet e ndryshme të lëngjëve të sistemeve më me shumë se një komponent. Në rast të bashkëveprimeve të theksuara ndermjet molekulave të lëngjeve, në përqendrime të ulëta, madhësia Y^E ndodh të mos jap devijimin e saktë nga idealiteti. Vetitë termodinamike shtesë kanë rëndësi për të studiuar bashkëveprimet e ndryshme molekulare si dhe renditjet (paketimet) ndermjet molekulave.

Për përzierjet binare funksioni i përgjithshëm i vetive termodinamike shtesë është dhënë me shprehjen:

$$Y^E = Y - x_1 Y_1 - x_2 Y_2$$

Ku Y^E paraqet vetinë termodinamike shtesë, e cila mund të jetë energjia e lirë e Gibbsit, entalpia, vëllimi molar i përzierjes, ngjeshmëria izentropike shtesë, devijimi në indeksin e thyerjes, ndërsa x_1 dhe x_2 paraqesin fraksionet molare dhe Y_1 dhe Y_2 paraqesin vetitë e lëngjeve të pastra 1 dhe 2.

Për një përzierje ideale të dy lëngjëve, vëllimi total i përzierjes është shuma e dy vëllimeve të lëngjëve të pastra individuale. Por tek përzierja reale, tek vëllimi total i dy lëngjeve të pastra kemi zvogëlim ose rritje në vëllim. Kjo mund të shpjegohet me anë të bashkëveprimeve ndermjet molekulave të të dy komponenteve individuale. Ky zvogëlim ose rritje në vëllim paraqet vëllimin molar shtesë. Vëllimi molar shtesë mund të paraqitet me anë të ekuacionit:

$$V_m^E = V_m - x_1 V_{m,1} - x_2 V_{m,2}$$

Ku V_m^E paraqet vëllimin molar shtesë të përzierjes, $V_{m,1}$ dhe $V_{m,2}$ paraqesin vëllimet molare të lëngjeve të pastra dhe x_1 dhe x_2 paraqesin fraksionet molare të lëngjeve të pastra. Vëllimi i përzierjes së tretësirave të pastra dhe ai për tretësirë të pastër duhet të matet në kushte të njëjta të përbërjes, temperaturës dhe presionit. Pra, vëllimi molar i tretësirës paraqet sasinë e vëllimit shtesë i tretësirës ndaj vëllimit të tretësirës ideale dhe mund të paraqesim me një ekuacion më të thjeshtë:

$$V_m^E = V_m - V_m^{id}$$

Vëllimi molar është:

$$V_m = \frac{M}{\rho}$$

ku $M = x_1 M_1 + x_2 M_2$

Vëllimi molar ideal jepet me këtë ekuacion:

$$V_m^{id} = \frac{x_1 M_1}{\rho_1} + \frac{x_2 M_2}{\rho_2}$$

Duke i rregulluar ekuacionet e mësipërme vëllimi molar shtesë merr formën

$$V_m^E = \frac{x_1 M_1 + x_2 M_2}{\rho} - \left(\frac{x_1 M_1}{\rho_1} + \frac{x_2 M_2}{\rho_2} \right)$$

ku M_1 dhe M_2 paraqesin masat molare të dy lëngjeve të pastra, kurse ρ_1 dhe ρ_2 paraqesin densitetet e dy lëngjeve të pastra, ndërsa ρ paraqet densitetin e përzierjes së lëngjeve.

Në përgjithësi vëllimi molar shtesë me dy e më shumë komponente mund të shkruhet:

$$V_m^E = \sum_{i=1}^p x_i M_i (\rho^{-1} - \rho_i^{-1})$$

ku p – numri komponenteve.

2.2.2. Ngjeshmëria izentropike shtesë

Ngjeshmëria izentropike shtesë κ_S^E llogaritet si ndryshim në mes të ngjeshmërisë izentropike eksperimentale κ_s dhe kompresibilitetit izentropik ideal κ_S^{id}

$$\kappa_S^E = \kappa_s - \kappa_S^{id}$$

ku κ_s përcaktohet me matje eksperimentale të densitetit dhe shpejtësisë ultrasonike duke e përdorur ekuacionin

$$\kappa_s = \frac{1}{\rho u^2}$$

Ndërsa ngjeshmëria izentropike ideale κ_S^{id} llogaritet duke përdorur ekuacionin e mëposhtëm

$$\kappa_S^{id} = \sum_{i=1}^p \phi_i (\kappa_{S,i} + TV_{m,i} \alpha_{P,i}^2 / C_{P,i}) - T \left(\sum_{i=1}^p x_i V_{m,i} \right) \left(\sum_{i=1}^p \phi_i \alpha_{P,i} \right)^2 / \sum_{i=1}^p x_i C_{P,i}$$

ku ϕ_i – paraqet fraksionin molar të komponentes i , T – temperaturën, $V_{m,i}$ – vëllimin molar të komponentes i , $\kappa_{S,i}$ – ngjeshmëria izentropike të komponentes i , $\alpha_{P,i}$ – koeficienti i zgjerimit termik isobarik të komponentes i dhe $C_{P,i}$ – kapaciteti termik molar isobarik të komponentes i .

2.2.3. Devijimi në indeks të thyerjes

Devijimet e indeksit të thyerjes u përcaktuan në bazë të të dhënave eksperimentale të indeksit të thyerjes së përzierjes dhe përbërësit e saj të pastër

$$\Delta n = n - \sum_{i=1}^p x_i n_i$$

ku Δn është devijimi në indeks të thyerjes, n është indeksi i thyerjes së përzierjes, x_i është fraksioni molar dhe n_i është indeksi i thyerjes së komponentes i .

2.3. KORELIMI DHE PARASHIKIMI I VETIVE SHITESË

Për analizën e vetitë termodinamike shtesë të përzierjve të lëngjëve dyshe përdoret ekuacioni me polinome sipas Redlich-Kister-it [19]

$$Y^E = x_i x_j \sum_{p=0}^n A_p (x_i - x_j)^p$$

Y^E paraqet vetinë termodinamike shtesë, x_i dhe x_j paraqesin fraksionin molar të komponentëve i dhe j , A_p paraqet koeficientet e përqasjes sipas Redlich-Kisterit, i cili fitohet me anë të përqasjes së ekuacionit në rezultatet eksperimentale duke përdorur metodën e katrorëve të vegjël dhe n paraqet numrin e parametrave të përqasjes, p paraqet shkallën e përqasjes. Kështu që duke përdorur ekuacionin e lartshënuar mund të korrelohen vetitë termodinamike shtesë, në rastin tonë vëllimi molar shtesë dhe ngjeshmëria izentropike shtesë, po ashtu edhe devijimi në indeksin e thyerjes. Ekuacioni i mësipërm në këtë rast merr formën:

$$Y^E(V_m^E; \kappa_S^E; \Delta n) = x_1(1 - x_1) \sum_{p=0}^n A_p (2x_1 - 1)^p$$

Vlerësimi i parametrave të Redlich – Kister – it janë bërë duke përdorur F -tesin (>0.05)[20]

Vetitë termodinamike shtesë te sistemeve treshe po ashtu mund të korrelohen duke përdorur ekuacion e mirënjohur të Cibulka [21]

$$Y_{123} = \sum_{i=1}^3 \sum_{j>i} Y_{ij} + x_1 x_2 (1 - x_1 - x_2) (C_0 + C_1 x_1 + C_2 x_2)$$

Ku Y_{123} paraqet V_m^E , κ_S^E ose Δn , të përzierjeve treshe, Y_{ij} është kontributi binar i cdo çifti i - j i llogaritur duke përdorur ekuacionin 2.12. C_0 , C_1 dhe C_2 janë koeficientët e Cibulkës.

Devijimi standard i vetive termodinamike shtesë të studiuara në kuadër të këtij hulumtimi llogaritet me shprehjen:

$$\sigma = \sqrt{\frac{\sum_{i=1}^n (Y_{exp}^E - Y_{llog}^E)}{N - n}}$$

Ku N është numri i matjeve dhe n është numri i parametrave optimal të ekuacionit, Y_{exp}^E – vetitë shtesë eksperimentale dhe Y_{llog}^E – vetitë shtesë të llogaritura (koreluar).

2.4 . VLERËSIMI I PAPERCAKTUESHMËRIVE NË MATJE

Vlerësimi i papërcaktueshmërive behet në dy mënyra, papërcaktueshmëria e tipit A (e cila vlerësohet me qasje statistikore) dhe papërcaktueshmëria e tipit B (e cila vlerësohet me qasje jo statistikore). Llogaritje e papërcaktueshmërive shpesh bëhet duke i kombinuar të dy llojet e papërcaktueshmërive, në këtë punim llogaritja e pasaktësive bëhet me metoden e kombinuar [22].

Madhësitë fizike mund të maten direkt dhe indirekt, nëse madhësia e cila matet indirekt është y , ndërsa madhësia e cila matet direkt është x , atëherë funksioni y mund të shkruhet si $y = f(x_1, x_2, x_3 \dots x_n)$. Papërcaktueshmëria standarde është dhënë me ekuacionin:

$$u^2(y) = \left(\frac{\partial y}{\partial x_1}\right)^2 u^2(x_1) + \left(\frac{\partial y}{\partial x_2}\right)^2 u^2(x_2) + \left(\frac{\partial y}{\partial x_3}\right)^2 u^2(x_3) + \dots + \left(\frac{\partial y}{\partial x_n}\right)^2 u^2(x_n)$$

Ose në formë me kompakte

$$u^2(y) = \sum_{i=1}^n \left(\frac{\partial y}{\partial x_i}\right)^2 u^2(x_i)$$

Me anë të këtij ekuacioni janë llogaritur papërcaktueshmëritë standarde, duke u bazuar në papërcatueshmëritë standarde të madhësive $(x_1, x_2, x_3 \dots x_n)$.

Papërcaktueshmëria e zgjeruar është

$$U(y) = k u(y)$$

ku k është faktori i zgjerimit, ky faktor zgjidhet për të përcaktuar intervalin e pasigurisë që mbulon vlerën e vërtetë të madhësisë me një probabilitet të lartë besueshmërie. Zakonisht merret faktori i zgjerimit $k = 2$, që do të thotë se niveli i besueshmërisë është 95%. $u(y)$ është papërcaktueshmëria standarde.

Papërcaktueshmëria e zgjeruar në nivelin e besueshmërisë k është

$$U(y) = k \sqrt{\left(\frac{\partial y}{\partial x_1}\right)^2 u^2(x_1) + \left(\frac{\partial y}{\partial x_2}\right)^2 u^2(x_2) + \left(\frac{\partial y}{\partial x_3}\right)^2 u^2(x_3) + \dots + \left(\frac{\partial y}{\partial x_n}\right)^2 u^2(x_n)}$$

Përkatesisht

$$U(y) = k \sqrt{\sum_{i=1}^n \left(\frac{\partial y}{\partial x_i}\right)^2 u^2(x_i)}$$

ku n është numri i madhësive të cilat mund të maten direkt.

Papërcaktueshmëria standarde e temperaturës është vlerësuar të jetë $u(T) = 0.01 \text{ K}$, në fraksione molare $u(x_1) = 1 \cdot 10^{-4}$. Papërcaktueshmëria e zgjeruar në nivel të besueshmërisë $k = 2$, (95%) në densiteti ρ , është vlerësuar të jetë $U(\rho) = 0.0005 \frac{\text{g}}{\text{cm}^3}$, në shpejtësi të zërit u , është $U(u) = 0.5 \frac{\text{m}}{\text{s}}$, në indeksin e thyerjes është $U(n) = 0.0002$. Për sistemet dyshe papërcaktueshmëria e zgjeruar ($k = 2$) në vëllimin molar shtesë është vlerësuar të jetë më e vogël se $U(V_m^E) = 0.017 \text{ cm}^3 \cdot \text{mol}^{-1}$, për ngjeshmërinë izentropike shtesë $U(\kappa_S^E) = 1.0 \text{ TPa}^{-1}$ dhe në devijim në indeks të thyerjes $U(\Delta n) = 0.0002$. Për sistemet treshe papërcaktueshmëria e zgjeruar në vëllimin molar shtesë është vlerësuar të jetë më e vogël se $U(V_m^E) = 0.023 \text{ cm}^3 \cdot \text{mol}^{-1}$, në ngjeshmëria izentropike shtesë $U(\kappa_S^E) = 1.7 \text{ TPa}^{-1}$ dhe në devijimin në indeks të thyerjes $U(\Delta n) = 0.0003$. Për sistemin katërshe papërcaktueshmëria e zgjeruar në vëllimin molar shtesë V_m^E , është $U(V_m^E) = 0.038 \text{ cm}^3 \cdot \text{mol}^{-1}$, në ngjeshmërinë

izentropike shitesë κ_S^E , është $U(\kappa_S^E) = 3.2 \text{ TPa}^{-1}$ dhe në devijimin në indeks të thyerjes Δn , është $U(\Delta n) = 0.0006$.

3. PJESA EKSPERIMENTALE

Të gjitha matjet eksperimentale të densitetit, shpejtësisë së zërit dhe indeksit të thyerjes për sistemet dyshe, treshe dhe sistemin katërsh janë realizuar në Laboratorin e termodinamikes teorike dhe eksperimentale në Departamentit e Fizikës pranë Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore, në Universitetin e Prishtinës në bashkëpunim me Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, Universiteti Politeknik i Tiranës. Përgatitja e përzierjeve me përqendrime të ndryshme në fraksione molare është bërë duke përdorur substanca të pastra nga prodhues të njohur (shih tabelën 1).

3.1. SUBSTANCAT E PËRZGJEDHURA PËR KËTË HULUMTIM

Tretësit organikë, të njohur si tretës me bazë karboni, kanë disa veti kryesore si avullueshmëria, pika e vlimit, masa molekulare dhe ngjyra. Ata përdoren gjerësisht si tretës për shumë qëllime, por shpesh kërkohet të mendojmë për aspektin toksikologjik të tyre. Të gjithë tretësit organikë, në një farë mase, janë të dëmshëm për shëndetin kur thithen ose gëlltiten në sasi më të mëdha se kufizimet e lejuara. Shumica e tyre, në kontakt me lëkurën, shkaktojnë acarim.

Ndër tretësit më të zakonshëm përmenden metanoli, etanoli, acetoni, heksani, heptani, diklor metani, tetrahidrofurani, etil acetati, acetonitrila, tolueni dhe dimetilsulfoksidi. Ata përdoren rregullisht nga studiues dhe punonjës në industrinë kimike dhe institutet kërkimore, duke u bërë të rëndësishëm në shumë aspekte të industrisë dhe shkencës. Megjithatë, shumë persona mund të ekspozohen ndaj tretësve organikë edhe përmes ndotjes së mjedisit.

Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj këtyre tretësve mund të ndikojë negativisht në funksionimin e sistemit nervor qendror dhe pjesëve të tjera të trupit. Efektet varen nga përqendrimi, kohëzgjatja, frekuenca dhe lloji i tretësve të përdorur, duke shkaktuar simptoma si dhimbje koke, marramendje, lodhje, mungesë përqendrimi, ndryshime në sjellje, humbje të ndjenjave dhe, në raste ekstreme, mund të jenë edhe fatale.

Prezenca e tretësve organikë në produktet ushqimore, si perimet, frutat, mishi etj., kontribuon në prishjen më të shpejtë të tyre kur ruhen për periudha të gjata në temperaturën e dhomës. Kjo ndodh si rezultat i nxitjes së zhvillimit të reaksioneve kimike në prezencë të këtyre tretësve. Tretësit organikë të zakonshëm klasifikohen në disa grupe, si: hidrokarbure alifatike, hidrokarbure aromatike, hidrokarbure ciklike, hidrokarbure të halogjenuara, amina, estere,

etere, aldehide dhe ketone. Sintetizimi organikë është i vështirë që mund të realizohet pa praninë e tretësve organikë, pasi këta janë substanca kimike që përdoren për të tretur substanca të tjera.

Reaktiviteti i tretësve organikë në kushte të caktuara është një faktor i rëndësishëm për t'u marrë parasysh. Mënyra se si zgjidhen tretësit sot ka ndryshuar ndjeshëm krahasuar me të kaluarën, për shkak të rregullave të rrepta që lidhen me toksicitetin dhe sigurinë në mjediset ku përdoren. Kriteret për zgjedhjen e tretësve përfshijnë fuqinë tretëse dhe avullueshmërinë e tyre, të cilat mund të ndikojnë në shëndetin e studiuesve dhe të tjerëve që janë të ekspozuar ndaj tyre.

Njohuritë e avancuara në këtë fushë orientojnë hulumtuesit drejt opsioneve më të sigurta dhe më të qëndrueshme, duke kërkuar gjithashtu mundësi për të realizuar sintezën organike pa përdorimin e tretësve organikë.

3.3.1. Tert-butili metil eteri (MTBE)

Tert-butili metil eteri (MTBE) - ($C_5H_{12}O$) është lëng volatil pa ngjyrë me aromë karakteristike dhe është i ndezshëm. Ai bën pjesë në komponime organike që në zinxhirin e atomeve të karbonit dhe hidrogjenit kanë të lidhura edhe atome të oksigjenit të njohura si komponime eterike. Komponimet eterike së bashku me alkoolët bëjnë pjesë në oksigjenate. Oksigjenatet përdoren si mjete shtesë në karburante për të mundësuar djegien e plotë të tij, e kështu duke i reduktuar emetimet toksike të monoksidit të karbonit (CO) dhe ozonit (O_3) në motorat me djegie të brendshme. Gjithashtu oksigjenatet kanë efekt në rritjen e numrit oktanik. MTBE kryesisht prodhohet me disa metoda, por metoda më e rëndomtë është ajo e sintezës ndërmjet izobutenit dhe metanolit. MTBE tretet mirë në ujë në temperaturë dhe presion standard, veti kjo që e dallon nga komponimet tjera të cilat gjenden në naftë, të cilat janë të tretshme vetëm në tretës organik. MTBE më së shumti përdoret si aditiv në benzinë, por përdoret edhe si intermediat në sintetizimin e izobutilenit, si tretës në industrinë farmaceutike, si tretës laboratorik dhe në mjekësi për të shkatërruar gurët në tëmth.

3.3.2. n-heksani

Heksani bën pjesë në klasën e komponimeve organike të quajtur alkane ose hidrokarbure alifatike me varg të ngopur. Në strukturën e vet ai ka gjashtë atome të karbonit të lidhura në zinxhirë të drejtë. n-Heksani është lëng i pangjyrë, shumë volatil me aromë shumë të keqe e të padurueshme. Zakonisht përdoret për ekstraktim të naftës si dhe për qëllime laboratorike. Në

shumicën e rasteve pastërtia nuk ka rëndësi, ndaj në treg gjenden me pastërti 20-80%. Papastërtitë që i përmban janë komponime të ndryshme organike si izomerë të heksanit, izomerë të heptanit, metilciklopentani, acetoni, metil etil ketoni, diklormetani, trikloretileni etj. Kryesisht gjendet në naftën e papërpunuar dhe gazin natyror. Fillimisht heksani u izolua nga cannel-coal naphtha, e më vonë u fitua nga distilati i kanelës. n-Heksani është shumë i ndezshëm dhe mund të digjet shpejt, kur vihet në kontakt me nxehtësinë, me flakë, me shkëndija dhe materiale oksiduese. Avujt e heksanit janë eksploziv. Si shumica e komponimeve organike, heksani nuk i përziehet me ujin, por përziehet mirë me komponime të tjera organike. n-Heksani në gjendje të pastër apo i përzier me tretës të tjerë të njohur me emra si “heksan komercial”, “heksane të përziera” etj. përdoret kryesisht për qëllime të ndryshme industriale. Nga përdorimet industriale të heksanit si tretës mund të përmendim: industrinë e ngjitësëve, ku n-heksani është pjesë përbërëse e tyre; industrinë e gomës, ku ai shërben për polimerizim; etj.. Përdorimi më i gjerë i heksanit mbetet në ekstraktimin e vajrave nga bimët si soja, pambuku, kikiriki etj.


3.3.3. Cikloheksani

Cikloheksani bën pjesë në grupin e komponimeve organike të quajtuara hidrokarbure aliciklike që ndryshe njihen si cikloalkane. Cikloheksani në strukturën e tij unazore ka gjashtë atome të karbonit. Ai është lëng pa ngjyrë dhe ka aromë të fortë të ngjashme me naftën. Në natyrë kryesisht gjendet në naftë të papërpunuar nga e cila përfitohet me anë të distilimit. Prodhimi industrial i tij bëhet me anë të hidrogjenizimit të benzenit në prani të katalizatorëve metalik. Cikloheksani është i patretshëm në ujë, por ka tretshmëri të mirë në tretës organikë. Përdorimet e cikloheksanit janë të shumta si: në prodhimin e acidit adipik dhe kaprolaktamit që shërbejnë për prodhimin e polimerit të najlonit, në prodhimin e kemikateve të tjera si benzenit, cikloheksanonit dhe nitrocikloheksanit. Cikloheksani përdoret edhe si tretës, si hollues në reaksione polimerike, në insekticide dhe masa plastike, si shtese në llaqe, rrëshira e fungicide, për largimin e ngjyrës, si mjet shtesë në karburante, si mediator etj. Roli i tij kryesor në laboratore është përdorimi si tretës organik jopolar.

3.3.4. Benzeni

Benzeni bënë pjesë në grupin e hidrokarbureve aromatike, dhe është përfaqësuesi kryesorë i këtij grupi. Benzeni është njëri nga hidrokarburet me të thjeshta. Formula molekulare e benzenit është C_6H_6 , paraqitet me një strukturë gjashtë këndëshe, të përbërë nga gjashtë atome të karbonit të lidhura me gjashtë atome të hidrogjenit. Struktura e benzenit mund të paraqitet edhe me një rreth në mes gjashtëkëndëshit, ku ky rreth tregon gjatë elektronet π të cilat janë të delokalizuar. Benzeni është një lëngë pa ngjyrë me një aromë të veçantë, nuk treten në ujë, por tretet shumë mirë me tretës të tjerë organik. Benzeni ka përdorim të gjerë në prodhimin e plastikës, në prodhimin e ngjyrave, industrinë e gomave, karburante.

Tabela 1. Të dhënat për kimikatet e përdorura

Substanca	Formula kimike	Struktura kimike	CAS #	Prodhuksi	Pastërtia (%)
MTBE ^a	$C_6H_{12}O$		1634-04-4	Biochem	≥ 99.5
n-heksan	C_6H_{14}		110-54-3	Sigma-Aldrich	≥ 99.0
Cikloheksan	C_6H_{12}		110-82-7	Merck	≥ 99.5
Benzen	C_6H_6		71-43-2	Sigma-Aldrich	≥ 99.7

^a MTBE – methyl *tert*-butyl ether

Pastërtia e kimikateve është kontrolluar duke i krahasuar vlerat e matura për dendësinë, shpejtësinë e zërit dhe indeksin e thyerjes, për substancat e pastërta me vlerat e raportuara në literaturë. Duke patur parasysh rezultatet e këtij studimi, lidhur me pastërtin e tretësve organikë, vlerat e këtyre tretësve përputhen mirë me literaturën (Tabela 2).

Tabela 2. Densiteti, shpejtësia ultrasonike dhe indeksi i thyerjes për substancat e pastërta, në temperaturën 298.15 K, në shtypje lokale atmosferike.

Substanca	$\rho(gcm^{-3})$		$u(ms^{-1})$		n	
	Eksp.	Lit.	Eksp.	Lit.	Eksp.	Lit.
MTBE	0.73524	0.7353 [23]	1035.9	1035[23]	1.3662	1.36597 [23]
		0.73521 [24]		1036.27 [24]		1.36648 [24]

		0.734915		1035.89		
		[25]		[25]		
n-heksan	0.65532	0.65520 [26]	1077.9	1077.0 [26]	1.3709	1.37234 [26]
		0.6550 [27]		1077.7 [27]		1.37211 [29]
		0.65496 [28]		1076.5 [28]		
cikloheksan	0.77391	0.7737 [27]	1254.5	1254.4 [27]	1.4234	1.4256 [31]
		0.77384 [7]		1253.9 [7]		1.42360 [7]
		0.77385 [30]		1253.0 [30]		
Benzen	0.87370	0.8736 [27]	1299.2	1299.7 [27]	1.4980	1.49774 [7]
		0.87395 [32]		1299.3 [32]		1.4979 [34]
		0.87361 [33]		1299.3 [33]		

Të gjitha përzierjet janë përgatitur sipas masës pak para zhvillimit të matjeve duke u mbajtur në enë hermetike prej qelqit. Avullimi preferencial gjatë përgatitjes së përzierjeve është minimizuar duke vendosur gjithmonë së pari komponentin me pikë më të lartë të avullimit. Hapësira e avullit (e lirë) në enët e qelqit është mbajtur në minimum për të shmangur humbjet nga avullimi.

Për të arritur objektivat e deklaruara kërkimore, për matje eksperimentale në këtë studim janë përzgjedhur tretësit organik si MTBE, n-heksani, cikloheksani dhe benzeni. Në tabelë 3 janë paraqitur sistemet dyshe, treshe dhe sistemi katërshe të përzgjedhura për matje, analizë dhe modelime eksperimentale.

Tabela 3 Sistemet dyshe, treshe dhe katërshe

Sistemi katërshe	Sistemet treshe	Sistemet dyshe
MTBE (1) + n-heksan (2) + cikloheksan (3) + benzen (4)	MTBE (1) + n-heksan (2) + cikloheksan (3) MTBE (1) + n-heksan (2) + benzen (4) MTBE (1) + cikloheksan (3) + benzen (4) n-heksan (2) + cikloheksan (3) + benzen (4)	MTBE (1) + n-heksan (2) MTBE (1) + cikloheksan (3) MTBE (1) + benzen (4) n-heksan (2) + cikloheksan (3) n-heksan (2) + benzen (4) cikloheksan (3) + benzen (4)

Përzierjet dyshe, treshe dhe katërshe janë përgatitur duke i futur me shiringë masat e njohura të lëngjeve të pastra në shishe qelqi me mbyllje hermetike. Për matjet e masës është përdorur peshorja e tipit KERN & Sohn ABS220-4N me ndarje prej $\pm 1 \times 10^{-4}$ g. Konvertimi nga masa në sasi të molare është bazuar në tabelën e masës atomike relative të vitit 2013, të publikuar nga IUPAC. Papërcaktueshmëria në fraksionin molar të përzierjeve të studiuara është vlerësuar të jetë më e vogël se $\pm 1 \times 10^{-4}$.

Të gjitha përzierjet janë përgatitur menjëherë përpara matjeve të densitetit, shpejtësisë së zërit dhe indeksin e thyerjes.

Densiteti dhe shpejtësia e zërit të lëngjeve të pastra dhe përzierjeve dyshe, treshe dhe të sistemit katërshe të studiuara janë matë duke përdorur analizatorin e densitetit dhe shpejtësisë së zërit model DSA 5000M (Anton Paar, Austri, Graz). Përsëritshmëria e instrumentit për dendësinë ka qenë $\pm 1 \times 10^{-6}$ g·cm⁻³ ndërsa për shpejtësinë e matjeve të zërit ka qenë $\pm 1 \times 10^{-1}$ m·s⁻¹, ndërsa indeksi i thyerjes është matur duke përdorur refraktometrin KRUSS (shih 3.3)

Matjet për densitet (ρ) dhe shpejtësi të zërit (u) mbuluan gjithë gamën e përqendrimit dhe u kryen në presionin atmosferik lokal prej ~950 hPa në temperaturë (293.15, 298.15 dhe 303.15) K. Ndërsa për indeksin e thyerjes (n) matjet janë realizuar në temperaturën 298.15 K në shtypje lokale atmosferike.

3.2. MATJA E DENSITETIT DHE SHPEJTËSISË ULTRASONIKE

Densiteti dhe shpejtësia e zërit e lëngjeve të pastra si dhe e përzierjeve janë matur me pajisje të ndryshme, por ndër më të sofistikuarat është analizuesi Anton Paar DSA 5000 M GmbH (figura 1).



Figura 1. Analizuesi Anton Paar 5000 M GmbH

Instrumenti në fjalë përmban një gyp oshilues të punuar nga qelqit i cili ka formën e shkronjës U në të cilin mund të matet koha e oshilimit. Ky është i punuar nga gypi borosilikat ose nga çeliku inox (stainless steel) (figura 2). Për të mos lejuar interferimin e vibrimeve harmonik të pjesëve të tjera të aparaturës gypi është i shtrënguar në masë të konsiderueshme nga të dy anët. Matjet bazohet në matjen e periodës së vibrimit të shkaktuar nga një kristal piezoelektrik.



Figura 2. Gyp oshiluesi punuar nga qelq borosilikat

Perioda e oshilimit τ mund të definohet si koha që gypi lëvizë para dhe prapa. Ndërsa frekuenca ν tregon se sa oshilime të tilla janë bërë për një sekondë. Lidhja në mes të frekuencës dhe periodës së oshilimit është dhënë me ekuacionin e njohur:

$$\vartheta = \frac{1}{\tau}$$

Secili gyp i qelqit vibron me një lëkundje karakteristike natyrale, por kur ai mbushet me një lëng, lëkundja e tij ndryshon si pasojë e masës së lëngut. Siç dihet, me rritjen e masës, frekuenca zvogëlohet dhe kështu rritet perioda e oshilimit. Lidhja në mes të periodës së oshilimit dhe densitetit është dhënë me ekuacion:

$$\rho = A + B\tau^2$$

Ku A dhe B janë konstante të instrumentit për secilin oshilator individual që tregojnë për elasticitetin, strukturën dhe masën e gypit matës. Këto konstante mund të përcaktohen me anë të dy kalibrimeve me mostrave që kanë densitet të dy a po më shumë lëngjëve të njohur si p.sh. me ajër të thatë dhe me ujë të dejonizuar.

Preciziteti i matjes së shpejtësisë së zërit është $\pm 0.1\text{m/s}$, kurse për densitet është $\pm 0.3 \times 10^{-5} \text{g/cm}^3$. Papërcaktueshmëria për shpejtësi të zërit është $\pm 1\text{m/s}$, kurse për densitet është $\pm 10^{-5} \text{g/cm}^3$.

Për matjen e shpejtësisë së zërit shfrytëzohet teknika e kohës së propagimit. Celula për matjen e shpejtësisë së zërit është e dizajnuar në atë mënyrë që mostra të futet në mes të dy transduktorëve piezoelektrik ultrasonik. Ku njëri transduktor shërben si emetues, kurse tjetri si marrës i valëve të zërit. Për llogaritje të shpejtësisë pjestohet distanca në mes të dy transduktorëve për kohën e propagimit të valëve të zërit.

3.3. MATJA E INDEKSIT TË THYERJES

Njohja e indeksit të thyerjes për një substancë, jep një pasqyrë mbi strukturën mikroskopike të atij materialit. Indeksi i thyerjes është njera nga vetitë më të rëndësishme të materialit dhe kjo veti mund të matet me refraktometër. Matja e indeksit të thyerjes ka një aplikim të gjerë në industri, si për monitorimin e parametrave gjatë procesit të prodhimit, po ashtu edhe për kontrollin e cilësisë.. Në industrinë ushqimore, aplikohet për matjen e përqendrimit të sheqerit në fruta, lëngje frutash, pije joalkoolike, për përcaktimin e përmbajtjes së yndyrës në qumësht etj. Në industrinë kimike përdoret për përcaktimin e përqendrimeve në proceset e distilimit ose rektifikimit. Përveç kësaj, matjet e indeksit të thyerjes kanë gjetur përdorim të gjerë në mjekësi dhe në industrinë e prodhimit të gjysmëpërçuesve.

Indeksi i thyerjes n është matur me refraktometer digjital Kruss të modelit DR6200-T.



Figura 3. Refraktometri digjital.

Matja e indeksit të thyerjes bazohet në përcaktimin e pikës së reflektimit total në mjedis. Kjo pajisje e përdorë një burim drite LED, me gjatësi valore 589.3 nm (gjatësia valore e dritës së natriumit – D).

Tabela 4. Specifikat teknike të pajisjes DR6200T

Rangu	Saktësia	Rezolucioni
1.33000 – 1.58000	0.00002	0.00001

Në pajisje është i integruar një termostat i tipit Peltier i cili e mbanë temperaturën konstante ($\pm 0.1K$).

Përzierja pëmes shirigut futet në celulen për matje (figura 3), vendoset temperatura në të cilën do të realizohet matja, duhet të pritët një kohë deri sa temperatura e perzierjes të jetë ekuilibruar, pastaj leshohet të kryhet matja. Pasi të jetë kryer matja, pajisja duhet të pastrohet (me alkool dhe ujë të destiluar).

Kalibrimi i pajisjes është bërë në mënyrë periodike me ujë ultra të pastër.

4. REZULTATET DHE DISKUTIMET E MATJEVE EKSPERIMENTALE

Të dhënat për densitetin dhe shpejtësinë e zërit janë matur në tërë rajonin e fraksioneve molare në temperaturën 293.15 K, 298.15 K dhe 303.15 K, ndërsa indeksi i thyerjes është matur po ashtu në tërë rajonin e fraksioneve molare por vetëm në temperaturën 298.15 K, edhe densiteti edhe shpejtësia e zërit edhe indeksi i thyerjes janë matur në shtypje lokale atmosferike. Për sistemet dyshe të studiuara në këtë punim ka të dhëna të raportuara në literaturë me shumë në temperaturën 298.15 K, por jo në rangun e temperaturave të paraqitura në këtë hulumtim. Për sistemet treshe nuk ka të dhënatë raportuara po ashtu as për sistemin katërsh nuk ka të dhëna të raportuara.

4.1. REZULTATET EKPERIMENTALE PËR SISTEMET DYSHE

4.1.1. Vëllimi molar shtesë

Faktorët të cilët çojnë në zgjerimin e vëllimit molar shtesë gjatë përzierjes së komponenteve të ndyshme janë:


- i. Prishja e lidhjeve molekulare (kontribut kimik)
- ii. Forca të dobëta të dispersionit të Londonit ndërmjet komponenteve në përzierje (kontribut fizik)
- iii. Pengesat sterike të cilat shkaktohen nga strukturat e molekulës së komponenteve
- iv. Paketimet jo të mira të molekulave në përzierje (kontribut strukturor)


Faktorët të cilët çojnë në tkurrjen e vëllimit molar shtesë gjatë përzierjes së komponenteve të ndyshme janë:

- i. Mbizotërimi i bashkëveprimeve të forta specifike si lidhje hidrogjenore, bashkëveprime dipol – dipol, ngarkesë – dipol (kontribut kimik)
- ii. Paketimi i mirë në mes të molekulave në përzierje (kontribut strukturor)


Vëllimet molare shtesë për përzierjet e studiuar janë dhënë në tabelat 18 - 23 në shtojcë. Ndërsa paraqitja grafike e vëllimit molar shtesë në funksion të fraksioneve molare është dhënë në figurën 4. Paraqitja grafike e vëllimit molar shtesë shfaqë vlera pozitive në të gjitha fraksionet molare dhe në të gjitha temperaturat e studiuar për sistemet MTBE (1) + n – heksan (2), MTBE (1) + cikloheksan (3), n – heksan (2) + cikloheksan (3), n – heksan (2) + benzen (4) dhe cikloheksan (3) + benzen (4), ndërsa për sistemin MTBE (1) + benzen (4) shfaqë vlera negative në të gjitha fraksionet molare të studiuar dhe në të gjitha temperaturat e studiuar. Gjithashtu nga fig 4. vërehet se temperatura në vëllimin molar shtesë ka ndikim të vogël te sistemet MTBE (1) + n – heksan (2), MTBE (1) + cikloheksan (3), n – heksan (2) + benzen (4) dhe cikloheksan (3) + benzen (4), ndërsa te sistemet MTBE (1) + benzen (4) dhe n – heksan (2) + cikloheksan (3) efekti i temperaturës sa i përket vëllimit molar shtesë është më i madhë.

Koeficientet e Redlich-Kisterit dhe devijimi standard për të gjitha sistemet në të gjitha temperaturat e studiuar janë dhënë në tabelen 25 në shtojcë.







(c)



(d)



(e)



(f)

Figura 4. Vellimi molar shtesë në funksion të fraksioneve molare për sistemet , (a) MTBE (1) + n – heksan (2), (b) MTBE (1) + cikloheksan (3), (c) MTBE (1) + benzen (4), (d) n – heksan (2) + cikloheksan (3), (e) n – heksan (2) + benzen (4) dhe (f) cikloheksan (3) + benzen (4), në temperaturat (▲) 293.15 K, (●) 298.15 K dhe (▼) 303.15 K. (—) polinomet e Redlich – Kisterit.

Lakorja e V_m^E është simetrike në për të gjitha sistemet e studiuara në përjashtim të sistemit MTBE (1) + benzen (4) dhe n – heksan (2) + cikloheksan (3).


Tabela 5. Vëllimi molar shtesë në fraksionin ekuimolar ($x_i=0.5$) në të gjitha temperaturat e studiuara.

T/K	(1) + (2)	(1) + (3)	(1) + (4)	(2) + (3)	(2) + (4)	(3) + (4)
293.15	0.419	0.318	-0.153	0.116	0.426	0.657
298.15	0.423	0.315	-0.171	0.102	0.415	0.662
303.15	0.437	0.314	-0.192	0.091	0.409	0.664


Pra nga figura 4 vërehet se në vëllimin molar shtesë më së shumti ndikon temperatura te sistemi MTBE (1) + benzen (4), dhe më së paku ndikon te sistemi cikloheksan (3) + benzen (4) . Po ashtu nga figura 4 dhe tabela 5 mund të vërejme se me rritjen e temperaturës rritet edhe vëllimi molar shtesë te sistemet MTBE (1) + n-heksan (2) dhe cikloheksan (3) + benzen (4), ndërsa te sistemet të tjera me rritjen e temperaturës vëllimi molar shtesë zvëgëlohet.

4.1.2. Ngjeshmëria izentropik shtesë


Ngjeshmëritë izentropike shtesë për sistemet dyshe të studiuara janë paraqitur në tabelen 18 - 23 në shtojcë, ndërsa paraqitja grafike e tyre në funksion të fraksioneve molare është dhënë në figuren 5. Nga paraqitja grafike shohim se vlera pozitive të ngjeshmërisë izentropike shtesë shfaqin sistemet: MTBE (1) + n-heksan (2) dhe cikloheksan (3) + benzen (4), ndërsa vlera negative për sa i përket këtij parametri shfaqin sistemet: MTBE (1) + cikloheksan (3), MTBE (1) + benzen (4), n-heksan (2) + cikloheksan (3) dhe n-heksan (2) + benzen (4).




(a)



(b)



(c)



(d)




Figura 5. Ngjeshmëria izentropik shtesë në funksion të fraksioneve molare për sistemet , (a) MTBE (1) + n – heksan (2), (b) MTBE (1) + cikloheksan (3), (c) MTBE (1) + benzen (4), (d) n – heksan (2) + cikloheksan (3), (e) n – heksan (2) + benzen (4) dhe (f) cikloheksan (3) + benzen (4), në temperaturat (▲) 293.15 K, (●) 298.15 K dhe (▼) 303.15 K. (—) polinomet e Redlich – Kisterit.

Tabela 6. Ngjeshmëria izentropike shtesë në fraksionin ekuimolar ($x_i=0.5$) në të gjitha temperaturat e studiuara.


T/K	(1) + (2)	(1) + (3)	(1) + (4)	(2) + (3)	(2) + (4)	(3) + (4)
293.15	25.7	-9.7	-66.6	-27.1	-32.9	24.2
298.15	27.9	-11.8	-72.8	-30.3	-36.4	25.2
303.15	30.2	-14.9	-79.9	-33.7	-40.1	26.5

Nga tabela 7 shihet se te sistemet: MTBE (1) + n-heksan (2) dhe cikloheksan (3) + benzen (4) në fraksionin ekuimolar me rritjen e temeperaturës rritet edhe ngjeshmëria izentropike shtesë, ndërsa te sistemet: MTBE (1) + cikloheksan (3), MTBE (1) + benzen (4), n-heksan (2) + cikloheksan (3) dhe n-heksan (2) + benzen (4) me rritjen e temperaturës rritet minimumi i ngjeshmërisë izentropike shtesë.


Nga Figura 5 shohim se temperatura ka ndikim më të madhë në ngjeshmërinë izentropike shtesë në sistemin MTBE (1) + benzen (4), ndërsa ndikim më të vogël ka në sistemin cikloheksan (3) + benzen (4). Kjo e dhënë konfirmohet edhe nga tabela 8.

4.1.3. Devijimi në indeks të thyerjes



Nga figura 6 shihet se të gjitha devijimet e indekseve të thyerjes për sistemet e studiuar në këtë hulumtim shfaqin vlera negative në të gjitha fraksionet molare, në temperaturën 298.15 K dhe në shtypje lokale atmosferik. Lakorja e cila e paraqet devijimin në indeks të thyerjes nuk është simetrike në asnjësin sistem të shqyrtuar.



(a)



(b)






Figura 6. Devijimi në indeks të thyerjes në funksion të fraksioneve molare për sistemet , (a) MTBE (1) + n – heksan (2), (b) MTBE (1) + cikloheksan (3), (c) MTBE (1) + benzen (4), (d) n – heksan (2) + cikloheksan (3), (e) n – heksan (2) + benzen (4) dhe (f) cikloheksan (3) + benzen (4), në temperaturën (●) 298.15 K. (—) polinomet e Redlich – Kisterit.

Tabela 7. Devijimi i indeksit të thyerjes në fraksionin ekuimolar ($x_i=0.5$) në tempepraturen 298.15 K

T/K	(1) + (2)	(1) + (3)	(1) + (4)	(2) + (3)	(2) + (4)	(3) + (4)
298.15	-0.0019	-0.0027	-0.0096	-0.0034	-0.0152	-0.0072

Nga tabela 9 vërehet se në fraksionin ekuimolar devijim minimal të indeksit të thyerjes shfaqë sistemi MTBE (1) + n – heksan (2) dhe devijim maksimal shfaqë sistemi MTBE (1) benzen (4).

4.2. KRAHASIMI I SISTEMEVE DYSHE ME LITERATUREN

4.2.1. Vëllimi molar shtesë

Në figuren 7 (a) është dhënë vëllimit molar shtesë për sistemin MTBE (1) + n-heksan (2) i fituar nga matjet tona (●) i krahasuar me literaturën. Vërehet se ka një perputhje mjaftë të mirë


me të dhënat e raportuara nga Rodriguez (★) [5] me të dhënat tona. Të dhënat për vëllimin molar shtesë të raportuara nga Kumaran (*) [3] shihet se kanë vlera me të vogla krahasuar me matjet tona.

Në figuren 7 (b) është paraqitë krahasimi i vëllimit molar shtesë për sistemin MTBE (1) + cikloheksan (3). Për efekt krahasimi janë marrë dy hulumtime për keto sisteme. Vërehet se V_m^E të raportuara nga Kumaran (★) [3] dhe Arbneshi (*) [35] kanë përputhje mjaftë të mirë me V_m^E të paraqitura nga ana e jonë (●).

Në figuren 7 (c) është paraqitur V_m^E i fituar nga matjet tona (●) dhe raportimi i V_m^E i fituar nga Han (★) [36] dhe Gonzales – Olmos (*) [21] për sistemin MTBE (1) + benzen (4). Të dhënat e raportuara nga Han nuk kanë një përputhje të mirë me të dhënat tona, përderisa ato të paraqitura nga Gonzales – Olmos kanë një përputhje me të mirë.

Në figuren 7 (d) është paraqitur V_m^E për sistemin n-heksan (2) + cikloheksan (3) i fituar nga matjet tona (●) dhe raportimi i V_m^E i fituar nga Balan (★) [36] dhe Tripathi (*) [37]. Të dhënat e paraqitura nga hulumtimi ynë kanë një përpuethshmëri më të mirë me të dhënat për V_m^E të raportuara nga Balan, ndersa me të dhënat e raportuara nga Tripathi nuk kanë një përpuethshmeri të mirë.

Në figuren 7 (d) është paraqitur V_m^E për sistemin n-heksan (2) + benzen (4) i fituar nga matjet tona (●) dhe raportimi i V_m^E i fituar Gonzales (★) [26] dhe Segade (*) [38]. Të dy autorët paraqesin vëllime molare shtesë me te uleta se sa është paraqitur nga ne.






Figura 7. Krahasoni i vëllimit molar shtesë me literaturën për sistemet (a) MTBE + n-heksan, (b) MTBE + cikloheksan (c) MTBE + benzen, (d) n-heksan + cikloheksan, (e) n-heksan + benzen dhe (f) Cikloheksan + benzen

Në figuren 7 (f) është paraqitur V_m^E për sistemin cikloheksan (3) + benzen (4) i fituar nga matjet tona (●) dhe raportimi i V_m^E i fituar Malek (★) [32] dhe Goates (*) [39]. Të dhënat e paraqitura nga të dy autoret përputhen mjaftë mirë me të dhenat tona.

Të gjitha krahasimet e paraqitura më lartë janë berë në temperaturën 298.15 K.

4.2.2. Ngjeshmëria izentropik shtesë

Nga figura 8 (a) shihet se ka një përputhje mjaftë të mirë e të dhenava për ngjeshmërinë izentropike shtesë të paraqitur nga Rodriguez (★) [5] me rezultatet e paraqitura nga ne (●) për sistemin MTBE (1) + n – heksan (2).


Krahasimi i κ_S^E për sistemin MTBE (1) + cikloheksan (3) është dhënë në figuren 11 (b) me matjet e paraqitura nga Arbnesi (★)[35], shihet se matjet kanë një përputhjen të mirë me matjet tona (●).

Në figuren 8 (c) janë paraqitur krahasimi i κ_S^E për sistemin MTBE (1) + benzen (4) të raportuara nga Gonzales – Olmos (★) [40] me matjet tona (●), shihet se ka një përputhje të mirë të dhënave.


Në figuren 8 (d) janë paraqitur krahasimi i κ_S^E për sistemin n-heksan (2) + cikloheksan (3) të raportuara nga Dominguez (★) [27] me matjet tona (●), shihet se ka një përputhje të mirë të dhënave.

Në figuren 8 (e) janë paraqitur krahasimi i κ_S^E për sistemin n-heksan (2) + benzen (4) të raportuara nga Gonzales (★) [41] me matjet tona (●). Të dhënat për κ_S^E , të raportuara nga Gonzales tregojnë një minimum me të lartë në krahasim me të dhënat e raportuara nga ne, po ashtu vërehet se me rritjen e përqendrimit të n – heksanit, ngjeshmëria izentropike shtesë, ka një mos përputhje me të thekësuar me matjet e paraqitura nga ne.


Në figuren 8 (f) janë paraqitur krahasimi i κ_S^E për sistemin cikloheksan (3) + benzene (4) të raportuara nga Gonzales (★) [7] me matjet tona (●), shihet se ka një përputhje të mirë të dhënave.




(a)



(b)



(c)



(d)






Figura 8. Krahاسimi i ngjeshmërisë izentropike shtesë me literaturën për sistemet (a) MTBE + n-heksan, (b) MTBE + cikloheksan (c) MTBE + benzen, (d) n-heksan + cikloheksan, (e) n-heksan + benzen dhe (f) cikloheksan + benzen

4.2.3. Devijimet në indeksin e thyerjes


Në figuren 9 është paraqitë krahاسimi i devijimit të indeksit të thyerjes i fituar nga matjet tona dhe devijimi i indeksit të thyerjes të raportuara nga hulumtues të ndyshëm. Në përgjithësi matja e indeksit të thyerjes, e pastaj llogaritja e devijimit të indeksit të thyerjes për përzierjet e lëngëshme nuk janë lehtë të krahasueshme. Nga figura 9 shihet se krahاسimi i devijimit të indeksin e thyerjes nuk ka përpuethshmëri të mirë (megjithatë tredi është i njëjtë) me matjet e paraqitura [5] për sistemin MTBE (1) + n – hexan (2). Përputhje më të mirë të devijimit të indeksit të thyerjes ka për sistemin cikloheksan (3) + benzen (4) në mes të matjeve tona me literaturën [7]. Në shtojcë në tabelën 24 janë dhënë indekset e thyerës dhe devijimet në indeks të thyerjes.



(a)



(b)



(c)




Figura 9. Krahassimi i devijimeve të indeksit të thyerjes me literaturën për sistemet (a) MTBE + n-heksan, (b) MTBE + cikloheksan, (c) n-heksan + cikloheksan, (d) n-heksan + benzen dhe (e) Cikloheksan. + benzen

Matje për indeksin e thyerjes për sistemin MTBE + benzen deri me tani nuk ka të raportuara në literature, për pasojë edhe nuk është bërë krahasimi i indeksit të thyerjes.

4.3. SISTEMET TRESHE

MTBE (1) + n - heksan (2) + cikloheksan (3)

Vëllimi molar shtesë V_m^E është pozitiv gjatë gjithë përbërjes treshe. Vlerat e V_m^E shpërndahen në mënyrë simetrike në përbërje të MTBE (1) + n – heksan (2) dhe MTBE (1) + cikloheksani (3) (Fig 10, a) që janë nën-sisteme binare. Në anën tjetër, vlerat e V_m^E janë të shpërndara në mënyrë asimetrike në përbërjet pranë n – heksanit (2) + cikloheksanit (3) në nën-sistemin binar. Për më tepër, vlerat maksimale të V_m^E , afërsisht $0.4 \text{ cm}^3 \cdot \text{mol}^{-1}$ të përzierjes treshe, gjenden pranë përbërjes ekuimolare të nën - sistemit binar MTBE (1) + n – heksan (2) (shih Fig. 4, a). Kjo sjellje e V_m^E të përzierjes treshe pasqyron, siç pritet për përzierje të lëngjeve organike që nuk formojnë komponime të reja, rezultatet V_m^E të nën-sistemeve të saj binare [42].

Në kontrast me grafikun tresh të V_m^E , grafiku treshë i κ_S^E (shih Fig. 10, b) tregon rajone me vlera negative dhe pozitive, të ndara nga ato vlera të fraksioneve molare të përbërësve në përzierje për të cilat $\kappa_S^E = 0$ (sjellja ideale). Vlerat maksimale dhe minimale të κ_S^E të përzierjes treshë gjenden përkatësisht pranë përbërjeve ekuimolare të nën-sistemeve binare MTBE (1) + n – heksan (2) dhe n – heksan (1) + cikloheksan (3). Për më tepër, vlerat treshë të κ_S^E janë të shpërndara pothuajse simetrikisht në përbërjet pranë të tri nën - sistemeve binare, duke reflektuar kështu një sjellje të kombinuar të vlerave binare të κ_S^E [42] (shih Fig 5 a, 5 b, 5 c dhe 10, b).

Në tabelën 32 janë dhënë vëllimet molare shtese dhe ngjeshmëria izentropike shtesë.




Figura 10. Izovijat për vëllimin molar shtesë(a), ngjeshmërinë izentropike shtesë (b) dhe devijimi në indeks të thyerjes (c) për sistemin MTBE (1) + n - heksan (2) + cikloheksan (3).

Të dhënat treshe të Δn janë negative në të gjithë përbërjen treshe, duke krijuar kështu një korelacion negativ me të dhënat treshe të V_m^E . Kjo marrëdhënie e kundërt në mes të të dhënave Δn dhe V_m^E ndodh shpesh dhe shërben si një mjet i vlefshëm për vlerësimin e qëndrueshmërisë të të dhënave V_m^E . Për më tepër, të dhënat treshe të Δn , ashtu si V_m^E , janë të shpërndara në mënyrë simetrike në përbërjet pranë nën - sistemeve binare MTBE (1) + n – heksan (2) dhe MTBE (1) + cikloheksan (3), por tregojnë një shpërndarje paksa asimetrike të vlerave në përbërjet pranë nën - sistemit binar n – heksan (2) + cikloheksan (3), duke ngjasuar kështu me sjelljen e kombinuar të vlerave të Δn të sistemeve binare (shih figurat 10 c, dhe 6). Në përmbledhje, V_m^E , κ_S^E dhe Δn reflektojnë së bashku sjelljen e përbërësve binarë, pasi nuk u vunë re efekte të dallueshme në përzierje treshe [42]. Indeksi i thyerjes së bashku me devijimin në indeks të thyerjes janë dhënë në tabelen 36 në shtojcë.

MTBE (1) + n - heksan (2) + benzen (4)

Vëllimi molar shtesë V_m^E në temeperaturen 293.15K, ka vlera pozitive në të gjithë regjionin e fraksioneve molare, ndersa në temeperaturen 298.15 dhe 303.15K V_m^E ka vlera pozitive dhe negative përgjatë fraksioneve molare të studiara të ndarë me vijen e cila ka vleren $V_m^E = 0$, ku në këtë rast përzierja sillet si ideale.

Vlerat e vëllimit molar shtesë, të paraqitura në figuren 11 (a) janë të shpërndara në menyrë simetrike në përbërjen MTBE (1) + n – heksan (2), MTBE (1) + benzen (4) dhe n – heksan (2) + benzen (4) që janë nën – sistemet binare të ketij sistemi.




Figura 11. Izovijat për vëllimin molar shtesë(a), ngjeshmëria izentropike shtesë (b) dhe devijimi në indeks të thyerjes (c) për sistemin MTBE (1) + n - heksan (2) + benzen (4).

Vlerat maksimale ndodhen pranë përbërjes ekuimolare të nën – sistemeve binare. Është vërejtur se ndikimi i temperaturës në vëllim molar shtesë të sistemi MTBE (1) + n – heksan (2) + benzen (4) është shumë i vogël. Kjo sjellje e V_m^E të përzierjes treshe pasqyron, siç pritet për përzierje të lëngjeve organike që nuk formojnë komponime të reja, rezultatet V_m^E të nën-sistemeve të saj binare [42]. Vlerat e kompresibilitetit izentropik shtesë, të paraqitura në figuren 11 b janë të shpërndara në mënyrë simetrike në përbërjen MTBE (1) + n – heksan (2) dhe MTBE (1) + benzen (4), kurse në formën josimetrike për n – heksan (2) + benzen (4).


Të dhënat treshe të κ_S^E tregojnë rajone me vlera negative dhe pozitive të ndara nga ato vlera të fraksioneve molare të përbërësve në përzierje për të cilat $\kappa_S^E = 0$ (shih fig. 11 b) – ku përzierja

treshe sillet si ideale në raport me këtë parameter. Vëllimi molar shtesë dhe ngjeshmëria izentropike shtesë janë paraqitë në tabelën 34 në shtojcë.

Të dhënat për devijim në indeksin e thyerjes kanë vlera negative në të gjithë regionin e fraksioneve molare (Fig. 11 c) . Vlerat e devijimit të indeksit të thyerjes janë të shpërndara në formen asimetrike për sistemin MTBE (1) + n – heksan (2), MTBE (1) + benzen (4) dhe n – heksan (2) + benzen (4), që konfirmohen si nën – sisteme binare. Indeksi i thyerjes dhe devijimet në indeks të thyerjes janë dhënë në tabelën 37 në shtojcë.

MTBE (1) + cikloheksan (3) + benzen (4)

Vëllimi molar shtesë V_m^E shfaq rajone me vlera negative dhe pozitive të ndara nga ato vlera të fraksioneve molare të përbërësve në përzierje për të cilat $V_m^E = 0$ (vija e ndërprerë në fig. 12 a) – ku përzierja ternare sillet si ideale. Vlerat minimale dhe maksimale të V_m^E të përzierjes ternare gjenden pranë përbërjeve ekuimolare të nën-sistemeve binare MTBE (1) + benzen (4) dhe cikloheksan (3) + benzen (4). Kjo sjellje e V_m^E të ky sistem pasqyron, siç pritet për përzierje të lëngjeve organike që nuk formojnë përbërje të reja, rezultatet V_m^E të nën-sistemeve të saj binare [43].






Figura 12. Izovijat për vëllimin molar shtesë (a), ngjeshmëria izentropike shtesë (b) dhe devijimi në indeks të thyerjes (c) për sistemin MTBE (1) + cikloheksan (3) + benzen (4).

Të dhënat treshe të κ_S^E tregojnë gjithashtu rajone me vlera negative dhe pozitive të ndara nga ato vlera të fraksioneve molare të përbërësve në përzierje për të cilat $\kappa_S^E = 0$ (shih fig. 12b) – ku përzierja ternare sillet si ideale për sa i përket këtij parametri. Në mënyrë të ngjashme me V_m^E , vlerat minimale dhe maksimale të κ_S^E të përzierjes ternare gjenden në përbërje pranë nën - sistemeve binare MTBE (1) + benzen (4) dhe cikloheksan (3) + benzen (4). Megjithatë, vija $\kappa_S^E = 0$ (vija e ndërprerë në fig. 12b) është më pranë përbërjeve të nën-sistemit binar cikloheksan (3) + benzen (4), në kontrast me vijën ternare të $V_m^E = 0$ që shfaqet pranë përbërjeve të MTBE (1) + benzen (4). Të dhënat për vëllimin molar shtesë dhe ngjeshmërinë izentropike shtesë janë paraqitë në tabelën 35.

Të dhënat e divijimit të indeksit të thyerjes janë negative në të gjithë përbërjen e fraksioneve molare. Indeksi i thyerjes dhe devijimi në indeks të thyerjes janë paraqitë në tabelën 38.

n-heksan (2) + cikloheksan (3) + benzen (4)

Vëllimi molar shtesë V_m^E ka vlera pozitive në të gjithë regjionin e fraksioneve molare dhe në temperaturat e studiara (figura 13 a). Vlerat e vëllimit molar shtesë, të paraqitura në figuren 13 (a) janë të shpërndara në menyrë simetrike në përbërjen cikloheksan (3) + benzen (4) dhe n-heksan (2) + benzen (4), ndërsa asimetrike për n-heksan (2) + cikloheksan (3), që janë në përkuthje me nën – sistemet binare të këtij sistemi (fig. 4 d, 4 e dhe 4 f).




Figura 13. Izovijat për vëllimin molar shtesë (a), ngjeshmërinë izentropike shtesë (b) dhe devijimi në indeks të thyerjes (c) për sistemin n-heksan (2) + cikloheksan (3) + benzen (4).

Të dhënat për κ_S^E tek ky sistem tregojnë rajone me vlera pozitive dhe negative të cilat janë të ndara me vijën në të cilën $\kappa_S^E = 0$ (figura 13 b), që do të thotë në këtë rast përzierja sillet si ideale. Vlerat minimale dhe maksimale të κ_S^E të përzierjes ternare gjenden pranë përbërjeve ekuimolare të nën-sistemeve binare të këtij sistemi. Lakoja e cila e paraqet ngjeshmërinë izentropike shtesë është simetrike për sistemet n-heksan (2) + benzen (4) dhe cikloheksan (3) + benzen (4), ndërsa asimetrike për sistemin n-heksan (2) + cikloheksan (3), kjo sjellje e lakores së κ_S^E e konfirmon faktin se ketë sisteme janë nën-sisteme dyshe të këtij sistemi tresh. Të dhënat

për vëllimin molar shtesë dhe ngjeshmërinë izentropike shtesë janë paraqitur në tabelën 35 në shtojcë.

Devijimi i indeksit të thyerejs të ky sistem përgjatë të gjitha fraksioneve molare ka vlera negative. Simetria dhe asimetria e paraqitjes grafike të Δn po ashtu konfirmojnë se këto sisteme janë nën-sisteme dyshe të këtij sistemi tresh. Të dhënat për indeksin e thyerejs dhe devijimin në indeks të thyerjes janë paraqitur në tabelën 39 në shtojcë.

4.4. SISTEMI KATËRSH

Në total janë përgatitur tetëdhjetë e katër përzierje për të mbuluar të gjithë regjionin e fraksioneve molare të sistemit katërsh MTBE (1) + *n*-heksan (2) + cikloheksan (3) + benzen (4), në regjionin e temperaturave 293.15K-303.15K, në shtypje lokale atmosferike. Sistemet dyshe të studiuara në këtë hulumtim, janë të raportuara nga autor të ndryshëm në rangje të tjera të temperaturave, në ragjet e temperaturave të studiuara nga ne nuk hasen në literaturë. Ndërsa sistemet treshe MTBE (1) + *n*-heksan (2) + cikloheksan (3), MTBE (1) + *n*-heksan (2) + benzen (4), MTBE (1) + cikloheksan (3) + benzen (4) dhe *n*-heksan (2) + cikloheksan (3) + benzen (4) si dhe sistemi katërsh MTBE (1) + *n*-heksan (2) + cikloheksan (3) + benzen (4) nuk janë të studiuar më parë.

Vëllimi molar shtesë të ky sistem katërsh është pozitiv në të gjitha fraksionet molare në rangun e temperaturave të studiuara, përderisa ngjeshmëria izentropik shtesë dhe devijimi në indeks të thyerejs kanë vlera negative. Të dhënat për vëllimin molar shtesë dhe për kompresibilitetin izentropik shtesë janë dhënë në tabelën 41.

Ngjashëm si për sistemet treshe, edhe për sistemin katërsh është e pritshme që sjellja e V^E , κ_S^E dhe Δn të pasqyrohet në vlerat e këtyre parametrave të nënsistemeve të tyre dyshe. Të dhënat për indeksin e thyerjes dhe devijim në indeks të thyerejs janë dhënë në tabelën 42.

5 KORELIMI I VETIVE TEMODINAMIKE DUKE PËRDORUR MODELIN JOUYBAN – ACREE

5.1. KORELIMI I VETIVE TERMODINAMIKE TË SISTEMEVE DYSHE


Modeli Jouyban–Acree [44] është përdorur për të korreluar densitetin, shpejtësinë e zeri, koeficientin e zgjerimit izobarik dhe kompresibilitetin izentropik të përzierjeve dyshe, treshe dhe katërshe të studiuara. Modeli Jouyban – Acree ofron një model matematikor për të përfaqësuar në mënyrë të saktë varshmërinë e vetive fiziko – kimike të përzierjes në temperatura të ndryshme të përzierjes. Ky model për përzierje dyshe është:

$$\ln Y_{ij,T} = x_1 \ln Y_{i,T} + x_j \ln Y_{j,T} + \sum_{k=0}^2 J_k \left[\frac{x_i x_j (x_i - x_j)^k}{T} \right]$$


ku $Y_{ij,T}$ janë vlerat e densitetit, shpejtësisë së zetit, koeficientit të zgjerimit izobarik dhe ngjeshmërinë izentropike të përzierjes dyshe; $Y_{i,T}$ dhe $Y_{j,T}$ janë densiteti, shpejtësia e zetit, koeficienti i zgjerimit izobarik dhe ngjeshmëria izentropik në temperaturën T e komponentes i dhe j ; $i-j$ ($i = 1, 2$, dhe 3 ; $i < j$); x_i dhe x_j janë fraksionet molare të komponentes i dhe j . Ndërsa J_k paraqet koeficientet e modelit korreloes Jouyban – Acree të cilët mund të llogariten nga regresioni $\ln Y_{ij,T} - x_i \ln Y_{i,T} - x_j \ln Y_{j,T}$ në funksion të $x_i x_j / T$, $x_i x_j (x_i - x_j) / T$, dhe $x_i x_j (x_i - x_j)^2 / T$ duke përdorur analizen e katrorëve më të vegjel me intercept zero [45].

5.1.1. Korelimi i densitetit (ρ)


Nga figura 14 shihet se densitet e modeluara duke e përdorur modelin Jouyban-Acree korelojnë shumë mirë me densitetet e fituara nga matjet eksperimentale. Duke u bazuar në koeficientin e korelacionit të të dhënave R^2 mund të themi se më së miri korelojnë densitetet e sistemit n-heksan (2) + cikloheksan (3), ndërsa më së dobëti ato të sistemit cikloheksan (3) + benzen (4).




(a)




(b)




(c)



(d)



(e)




(f)


Figura 14. Densiteti i modeluar (ρ_{mod}) në funksion të densitetit ekperimental (ρ_{exp}), për sistemet , (a) MTBE (1) + n – heksan (2), (b) MTBE (1) + cikloheksan (3), (c) MTBE (1) + benzen (4), (d) n – heksan (2) + cikloheksan (3), (e) n – heksan (2) + benzen (4) dhe (f) cikloheksan (3) + benzen (4).

5.1.2. Korelimi i shpejtësisë së zërit (u)


Nga figura 15 shihet se shpejtësitë e zërit të modeluara duke e përdorur modelin Jouyban-Acree korelojnë mirë me shpejtësitë e zërit të fituara nga matjet eksperimentale. Duke u bazuar në koeficientin e korelacionit të të dhënave R^2 mund të themi se më së miri korelojnë shpejtësitë e zërit të sistemit MTBE (1) + cikloheksan (3), ndërsa më së dobëti ato të sistemit cikloheksan (3) + benzen (4).




(a)




(b)




(c)



(d)



(e)




(f)


Figura 15. Shpejtësia e zërit i modeluar (u_{mod}) në funksion të shpejtësisë së zërit eksperimental (u_{exp}), për sistemet , (a) MTBE (1) + n – heksan (2), (b) MTBE (1) + cikloheksan (3), (c) MTBE (1) + benzen (4), (d) n – heksan (2) + cikloheksan (3), (e) n – heksan (2) + benzen (4) dhe (f) cikloheksan (3) + benzen (4).

5.1.3. Korelimi i koeficientit të zgjerimit (α)


Nga figura 16 shihet se koeficientet e zgjerimit të modeluar duke e përdorur modelin Jouyban-Acree korelojnë mirë me koeficientet e zgjerimit të fituar nga matjet eksperimentale. Duke u bazuar në koeficientin e korelacionit të të dhënave R^2 mund të themi se më së miri korelojnë koeficientet e zgjerimit të sistemit MTBE (1) + cikloheksan (3) me ato eksperimentale, ndërsa më së dobëti ato të sistemit cikloheksan (3) + benzen (4).




(a)




(b)




(c)



(d)



(e)




(f)


Figura 16. Koeficienti i zgjeruar i modeluar (α_{mod}) në funksion të koeficientit të zgjerimit ekperimental (α_{exp}), për sistemet , (a) MTBE (1) + n – heksan (2), (b) MTBE (1) + cikloheksan (3), (c) MTBE (1) + benzen (4), (d) n – heksan (2) + cikloheksan (3), (e) n – heksan (2) + benzen (4) dhe (f) cikloheksan (3) + benzen (4).

5.1.4. Korelimi i ngjeshmërisë izentropike (κ_S)


Nga figura 17 shihet se ngjeshmeritë izentropike të modeluar duke e përdorur modelin Jouyban-Acree korelojnë shumë mirë me ngjeshmeritë izentropike të fituar nga matjet eksperimentale. Duke u bazuar në koeficientin e korelacionit të të dhënave R^2 mund të themi se më së miri korelojnë ngjeshmeritë izentropike të sistemit MTBE (1) + benzen (4) me ato eksperimentale, ndërsa më së dobëti ato të sistemit cikloheksan (3) + benzen (4).




(a)




(b)




(c)



(d)



(e)



(f)

Figura 17. Ngjeshmëritë izentropike të modeluar ($\kappa_{S,mod}$) në funksion të ngjeshmerive izentropike ekperimentale ($\kappa_{S,exp}$), për sistemet , (a) MTBE (1) + n – heksan (2), (b) MTBE (1) + cikloheksan (3), (c) MTBE (1) + benzen (4), (d) n – heksan (2) + cikloheksan (3), (e) n – heksan (2) + benzen (4) dhe (f) cikloheksan (3) + benzen (4).

Koeficientët korelues për densitetin, shpejtësinë e zërit, ngjeshmëritë izentropike dhe koeficientin e zgjerimit janë paraqitur në tabelën 26, 27, 28, 29, 30 dhe 31

5.2. KORELIMI I VETIVE TERMODINAMIKE TË SISTEMEVE TRESHE


Modeli Jouyban – Acree mund të përdoret për të korreluar densitetin, shpejtësinë e zërit, koeficientin e zgjerimit izobarik dhe ngjeshmeritë izentropike të përzierjes treshe në përqendrimet të dryshme dhe temperaturat të ndryshme.


$$\begin{aligned} \ln Y_{1,2,3,T} = & x_1 \ln Y_{1,T} + x_2 \ln Y_{2,T} + x_3 \ln Y_{3,T} + x_1 x_2 \sum_{k=0}^2 \left[\frac{A_k (x_1 - x_2)^k}{T} \right] \\ & + x_1 x_3 \sum_{k=0}^2 \left[\frac{B_k (x_1 - x_3)^k}{T} \right] + x_2 x_3 \sum_{k=0}^2 \left[\frac{C_k (x_2 - x_3)^k}{T} \right] \\ & + x_1 x_2 x_3 \sum_{k=0}^2 \left[\frac{D_k (x_1 - x_2 - x_3)^k}{T} \right], \end{aligned}$$

ku $Y_{123,T}$, janë vlerat numerike të densitetit, shpejtësisë së zerit, koeficientit të zgjerimit izobarik dhe ngjeshmerisë izentropike të përzierjes treshe; $Y_{1,T}$, $Y_{2,T}$, dhe $Y_{3,T}$ janë densiteti, shpejtësia e zerit, koeficienti i zgjerimit izobarik dhe ngjeshmëri aizentropik në temperaturën T e komponentes 1, 2, dhe 3; x_1 , x_2 dhe x_3 janë fraksionet molare të komponentes 1,2 dhe 3. Koeficientet e modelit korrelues për përzierje treshe A_k , B_k , C_k , and D_k mund të llogariten nga regresioni $\ln Y_{123,T} - x_1 \ln Y_{1,T} - x_2 \ln Y_{2,T} - x_3 \ln Y_{3,T}$ në $x_1 x_2 / T$, $x_1 x_2 (x_1 - x_2) / T$, $x_1 x_2 (x_1 - x_2)^2 / T$, $x_1 x_3 / T$, $x_1 x_3 (x_1 - x_3) / T$, $x_1 x_2 (x_1 - x_2)^2 / T$, $x_2 x_3 / T$, $x_2 x_3 (x_2 - x_3) / T$, $x_2 x_3 (x_2 - x_3)^2 / T$, $x_1 x_2 x_3 / T$, $x_1 x_2 x_3 (x_1 - x_2 - x_3) / T$, $x_1 x_2 x_3 (x_1 - x_2 - x_3)^2 / T$, duke përdorur analizen e katrorëve më të vegjel me intercept zero [45]. Vlerësimet e koeficientëve të këtij modeli janë bërë duke i larguar koeficientet të cilët e kanë signifikançen ($p > 0.01$).


5.2.1. Korelimi i densitetit (ρ)

Në përgjithësi vlerat e densiteteve të sistemeve treshe të studiuara korelohen mirë duke përdorur modelin Jouyban – Acree, por më së miri janë koreluar vlerat e densitetit të sistemit MTBE (1) + n – heksan (2) + cikloheksan (3), figura 18.





(c)




(d)


Figura 18. Densiteti i modeluar (ρ_{mod}) në funksion të densitetit ekperimental (ρ_{exp}), për sistemet , (a) MTBE (1) + n – heksan (2) + cikloheksan (3) , (b) MTBE (1) + n – heksan (2) + benzen (4), (c) MTBE (1) + cikloheksan (3) + benzen (4), (d) n – heksan (2) + cikloheksan (3) + benzen (4).

5.2.2. Korelimi i shpejtësisë së zërit (u)


Edhe vlerat e shpejtësive të zërit të sistemeve të studiuara janë të koreluara mirë por më së miri janë koreluar vlerat e shpejtësisë së sistemit MTBE (1) + cikloheksan (3) + benzen (4).




(a)



(b)



(c)




(d)


Figura 19. Shpejtësia e zërit e modeluar (u_{mod}) në funksion të shpejtësisë së zërit ekperimental (u_{exp}), për sistemet , (a) MTBE (1) + n – heksan (2) + cikloheksan (3) , (b) MTBE (1) + n – heksan (2) + benzen (4), (c) MTBE (1) + cikloheksan (3) + benzen (4), (d) n – heksan (2) + cikloheksan (3) + benzen (4).

5.2.3. Korelimi i koeficientit të zgjerimit (α)


Nga figura 20 shohim se vlerat e koeficientëve të zgjerimit më së miri janë modeluar për sistemin MTBE (1) + n – heksan (2) + cikloheksan (3).




(a)



(b)



(c)




(d)


Figura 20. Koeficienti i zgjerimit i modeluar (α_{mod}) në funksion të koeficientit të zgjerimit ekperimental (α_{exp}), për sistemet , (a) MTBE (1) + n – heksan (2) + cikloheksan (3) , (b) MTBE (1) + n – heksan (2) + benzen (4), (c) MTBE (1) + cikloheksan (3) + benzen (4), (d) n – heksan (2) + cikloheksan (3) + benzen (4).

5.2.4. Korelimi i ngjeshmërisë izentropike (κ_S)


Në figurën 21 shohim se vlerat e ngjeshmërisë izentropike më së mirë janë të modeluara te sistemit MTBE (1) + cikloheksan (3) + benzen (4), ndërsa më së dobëti te sistemit MTBE (1) + n – heksan (2) + benzen (4).




(a)



(b)



(c)



(d)

Figura 21. Ngjeshmëria izentropik e modeluar ($\kappa_{s, mod}$) në funksion të ngjeshmërisë izentropike ekperimentale ($\kappa_{s, exp}$), për sistemet, (a) MTBE (1) + n – heksan (2) + cikloheksan (3), (b) MTBE (1) + n – heksan (2) + benzen (4), (c) MTBE (1) + cikloheksan (3) + benzen (4), (d) n – heksan (2) + cikloheksan (3) + benzen (4).

Koeficientët korelues për densitetin, shpejtësinë e zërit, ngjeshmërinë izentropike dhe koeficientin e zgjerimit janë paraqitur në tabelën 43, 44, 45 dhe 46.

5.3. KORELIMI I VETIVE TERMODINAMIKE TË SISTEMIT KATËRSH

Modeli Jouyban – Acree mund të përdoret për të korreluar desitetin, shpejtësinë e zerit, koeficientin e zgjerimit izobarik dhe ngjeshmërinë izentropike të përzierjes së sistemit katërshe në përqendrime të dryshme dhe temperaturua të ndryshme.

$$\begin{aligned} \ln Y_{1,2,3,4,T} = & x_1 \ln Y_{1,T} + x_2 \ln Y_{2,T} + x_3 \ln Y_{3,T} + x_4 \ln Y_{4,T} + x_1 x_2 \sum_{k=0}^1 \left[\frac{A_k (x_1 - x_2)^k}{T} \right] \\ & + x_1 x_3 \sum_{k=0}^1 \left[\frac{B_k (x_1 - x_3)^k}{T} \right] + x_1 x_4 \sum_{k=0}^1 \left[\frac{C_k (x_1 - x_4)^k}{T} \right] \\ & + x_2 x_3 \sum_{k=0}^1 \left[\frac{D_k (x_2 - x_3)^k}{T} \right] \\ & + x_2 x_4 \sum_{k=0}^1 \left[\frac{E_k (x_2 - x_4)^k}{T} \right] + x_3 x_4 \sum_{k=0}^1 \left[\frac{F_k (x_3 - x_4)^k}{T} \right] \\ & + x_1 x_2 x_3 \sum_{k=0}^1 \left[\frac{G_k (x_1 - x_2 - x_3)^k}{T} \right] + x_1 x_2 x_4 \sum_{k=0}^1 \left[\frac{I_k (x_1 - x_2 - x_4)^k}{T} \right] \\ & + x_2 x_3 x_4 \sum_{k=0}^1 \left[\frac{J_k (x_2 - x_3 - x_4)^k}{T} \right] + x_1 x_2 x_3 x_4 \sum_{k=0}^1 \left[\frac{K_k (x_1 - x_2 - x_3 - x_4)^k}{T} \right] \end{aligned}$$

ku $Y_{123,4,T}$, janë vlerat numerike të desitetit, shpejtësisë së zerit, koeficientit të zgjerimit izobarik dhe kompresibilitetit izentropik të përzierjes katërshe; $Y_{1,T}$, $Y_{2,T}$, $Y_{3,T}$ dhe $Y_{4,T}$ janë desiteti, shpejtësia e zerit, koeficienti i zgjerimit izobarik dhe ngjeshmëri aizentropik në temperaturën T e komponentes 1, 2, 3 dhe 4; x_1 , x_2 , x_3 dhe x_4 janë fraksionet molare të komponentes 1,2, 3 dhe 4. Koeficientet e modelit korrelues për përzierje katërshe A_k , B_k , C_k , D_k , E_k , F_k , G_k , I_k , J_k dhe K_k mund të llogariten nga regresioni $\ln Y_{123,T} - x_1 \ln Y_{1,T} - x_2 \ln Y_{2,T} - x_3 \ln Y_{3,T} - x_4 \ln Y_{4,T}$ në $x_1 x_2 / T$, $x_1 x_2 (x_1 - x_2) / T$, $x_1 x_3 / T$, $x_1 x_3 (x_1 - x_3) / T$, $x_1 x_4 / T$, $x_1 x_4 (x_1 - x_4) / T$, $x_2 x_3 / T$, $x_2 x_3 (x_2 - x_3) / T$, $x_2 x_4 / T$, $x_2 x_4 (x_2 - x_4) / T$, $x_3 x_4 / T$, $x_3 x_4 (x_3 - x_4) / T$, $x_1 x_2 x_3 / T$, $x_1 x_2 x_3 (x_1 - x_2 - x_3) / T$, $x_1 x_2 x_4 / T$, $x_1 x_2 x_4 (x_1 - x_2 - x_4) / T$, $x_2 x_3 x_4 / T$, $x_2 x_3 x_4 (x_2 - x_3 - x_4) / T$, $x_1 x_2 x_3 x_4 / T$ dhe $x_1 x_2 x_3 x_4 (x_1 - x_2 - x_3 - x_4) / T$ duke përdorur analizen e katrorëve më të vegjel me intercept zero [45].

Vlerësimet e koeficientëve të këtij modeli janë bërë duke i larguar koeficientet të cilët e kanë signifkancën ($p > 0.01$).

Në figurën 22 shohim se vlerat e vetive termodinamike kanë një korrelim mjaft të mirë me matjet eksperimentale për sistemin katërsh MTBE (1) + n – heksan (2) + cikloheksan (3) + benzen (4). Koeficientet korelues janë dhënë në tabelën 47 në shtojcë.




Figura 22. Korrelimi i vetive termodinamike të sistemit tresh duke përdorur modelin korrelues Jouyban – Acree për sistemin katërsh MTBE (1) + n – heksan (2) + cikloheksan (3) + benzen (4).

6. PARASHIKIMI I VETIVE TERMOFIZIKE SHITESË DUKE PËRDORUR MODELET GJEOMETRIKE

6.1. PARASHIKIMI I VETIVE TERMOFIZIKE SHITESË PËR SISTEMET TRESHE

Duke ju referuar literaturës shohim se ka shumë shembuj të përdorimit të modeleve gjeometrike për parashikimin e vetive termofizike shtesë të sistemeve të përzierjeve të lengëshme treshe nga të dhënat e nënsistemeve të tyre dyshe [46], [47], [8]. Në këtë punim janë përdorur modelet simetrike Kohler [48] dhe Muggianu [49] dhe modelet asimetrike Toop dhe Hillert [50] për të parashikuar vetitë termodinamike shtesë. Simetria kuptohet si kontribut i barabartë i tri nën sistemeve binare në vetitë shtesë të sistemit tresh, ndërsa asimetria tregon një nga nën sistemet binare kontribuon ndryshe në vlerën e vetive shtesë të sistemit tresh.

Modeli Kohler

$$Y_{123}^E = (x_1 + x_2)^2 Y_{12}^E \left(\frac{x_1}{x_1 + x_2}; \frac{x_2}{x_1 + x_2} \right) + (x_1 + x_3)^2 Y_{13}^E \left(\frac{x_1}{x_1 + x_3}; \frac{x_3}{x_1 + x_3} \right) + (x_2 + x_3)^2 Y_{23}^E \left(\frac{x_2}{x_2 + x_3}; \frac{x_3}{x_2 + x_3} \right)$$

Modeli Muggianu

$$Y_{123}^E = \frac{4x_1x_2}{(1+x_1-x_2)(1+x_2-x_1)} Y_{12}^E \left(\frac{1+x_1-x_2}{2}; \frac{1+x_2-x_1}{2} \right) + \frac{4x_1x_3}{(1+x_1-x_3)(1+x_3-x_1)} Y_{13}^E \left(\frac{1+x_1-x_3}{2}; \frac{1+x_3-x_1}{2} \right) + \frac{4x_2x_3}{(1+x_2-x_3)(1+x_3-x_2)} Y_{23}^E \left(\frac{1+x_2-x_3}{2}; \frac{1+x_3-x_2}{2} \right)$$

Modeli Toop^a

$$Y_{123}^E = \frac{x_2}{1-x_1} Y_{12}^E(x_1; 1-x_1) + \frac{x_3}{1-x_1} Y_{13}^E(x_1; 1-x_1) + (1-x_1)^2 Y_{23}^E \left(\frac{x_2}{x_2+x_3}; \frac{x_3}{x_2+x_3} \right)$$

Modeli Toop^b

$$Y_{123}^E = \frac{x_1}{1-x_2} Y_{12}^E(1-x_2; x_2) + (1-x_2)^2 Y_{13}^E\left(\frac{x_1}{x_1+x_3}; \frac{x_3}{x_1+x_3}\right) + \frac{x_3}{1-x_2} Y_{23}^E(x_2; 1-x_2)$$

Modeli Toop^b

$$Y_{123}^E = (1-x_3)^2 Y_{12}^E\left(\frac{x_1}{x_1+x_2}; \frac{x_2}{x_1+x_2}\right) + \frac{x_1}{1-x_3} Y_{13}^E(1-x_3; x_3) + \frac{x_2}{1-x_3} Y_{23}^E(1-x_3; x_3)$$

Modeli Hillert^a

$$Y_{123}^E = \frac{x_2}{1-x_1} Y_{12}^E(x_1; 1-x_1) + \frac{x_3}{1-x_1} Y_{13}^E(x_1; 1-x_1) + \frac{x_2 x_3}{v_{23} v_{32}} Y_{23}^E(v_{23}; v_{32})$$

$$\text{ku} : v_{23} = \frac{1+x_2-x_3}{2} \text{ dhe } v_{32} = \frac{1+x_3-x_2}{2}$$

Modeli Hillert^b

$$Y_{123}^E = \frac{x_1}{1-x_2} Y_{12}^E(1-x_2; x_2) + \frac{x_1 x_3}{v_{13} v_{31}} Y_{13}^E(v_{13}; v_{31}) + \frac{x_3}{1-x_1} Y_{23}^E(x_2; 1-x_2)$$

$$\text{ku} : v_{13} = \frac{1+x_1-x_3}{2} \text{ dhe } v_{31} = \frac{1+x_3-x_1}{2}$$

Modeli Hillert^c

$$Y_{123}^E = \frac{x_1 x_2}{v_{12} v_{21}} Y_{12}^E(v_{12}; v_{21}) + \frac{x_1}{1-x_3} Y_{13}^E(1-x_3; x_3) + \frac{x_2}{1-x_3} Y_{23}^E(1-x_3; x_3)$$

$$\text{ku : } v_{12} = \frac{1+x_1-x_2}{2} \text{ dhe } v_{21} = \frac{1+x_2-x_1}{2}$$

Y_{123}^E – vetitë shtesë (V_m^E, κ_S^E dhe Δn), Y_{12}^E – kontributi binar i çiftit 1-2, Y_{13}^E – kontributi binar i çiftit 1-3, Y_{23}^E – kontributi binar i çiftit 2-3, x_1, x_2, x_3 – fraksionet molare përkatëse.

Si tregues statistikor për të testuar aftësinë e këtyre modeleve gjeometrike si parashikues të vetive termodinamike shtesë për përzierjet treshe janë përdorur devijimi mesatar i rrënjës katrore (RMSD):

$$RMSD = \sqrt{\frac{1}{n} \sum_{i=1}^n |(Y_{i,mod} - Y_{i,exp})^2|}$$

ku Y i referohet vetive termodinamike shtesë si V_m^E, κ_S^E dhe devijimit në indeks të thyerjes Δn , n është numri i matjeve, exp i referohet të dhënave eksperimentale dhe mod i referohet të dhënave të modeluara.

MTBE (1) + n -heksan (2) + cikloheksan (3)

Tabela 10 tregon se të gjitha modelet gjeometrike të testuara parashikojnë në mënyrë të kënaqshme V_m^E - në e sistemit tresh MTBE (1) + n -heksan (2) + cikloheksan (3), devijimi më i ulët është marrë nga modeli Hillert – tipi c, ku si komponentë asimetrike është cikloheksani dhe atë me vlerë afër vlerës së papërcaktueshmërisë së zgjeruar $U(V_m^E) = 0.015 \text{ cm}^3 \text{ mol}^{-1}$. Rezultatet tregojnë se devijimi më i ulët për κ_S^E është marrë nga modeli asimetric Toop dhe Hillert të tipit c ku si komponentë asimetrike është cikloheksani, vlera e devijimit është më e ulët se vlera e papërcaktueshmërisë së zgjeruar $U(\kappa_S^E) = 1.7 \text{ TPa}^{-1}$. Nga tabela 10 shihet se të gjitha modelet e testuara për parashikimin e κ_S^E japim vlera më të ulëta të devijimit se sa vlera e papërcaktueshmërisë në κ_S^E . Devijimi në indeks të thyerjes është parashikuar më së mirë me modelin simetrik Kohler me vlerë më të vogël se vlera e papërcaktueshmërisë së zgjeruar $U(\Delta n) = 0.0003$. Për parashikimin e V_m^E dhe κ_S^E vlera më të mëdha janë marrë nga modelet asimetrike Toop dhe Hillert të tipit b dhe nuk rekomandohet të përdoren si modele parashikuese në këtë sistem. Vlera më të mëdha të devijimit përparashikimin e Δn janë marrë nga modeli Hillert tipi c dhe nuk rekomandohet të përdoret për parashikim të këtij parametri.

Tabela 8. Devijimi mesatar i rrënjës katrore (RMSD) në mes të vlerave eksperimentale dhe vlerave të modeluara për sistemet tresh MTBE (1) + n-heksan (2) + cikloheksan (3) në temperaturën 298.15 K në shtypje lokale atmosferike.

Vetia/Modeli	V_m^E	κ_S^E	Δn
Kohler	0.023	1.02	0.00025
Muggianu	0.021	0.97	0.00035
Toop ^a	0.023	1.02	0.00031
Toop ^b	0.032	1.19	0.00030
Toop ^c	0.017	0.83	0.00039
Hillert ^a	0.022	0.98	0.00038
Hillert ^b	0.031	1.19	0.00030
Hillert ^c	0.017	0.83	0.00042

^aMTBE është komponenta asimetrike

^bn-heksan është komponenta asimetrike

^ccikloheksani është komponentë asimetrike

Figura 23 krahason të dhënat ekperimentale të koreluara me ekuacionin e Cibulkës të vëllimit molar shtesë me vlerat e parashikuara nga modeli Hillert tipi c për sistemin tresh MTBE (1) + n-heksan (2) + cikloheksan (3) në temperaturën 298.15 K. Nga figura shihet se në përgjithësi ka një përpuethshmëri të mire në mes të vlerave eksperimentale dhe të modeluara në përjashtin të izovijesë ($0.4 \text{ cm}^3 \text{ mol}^{-1}$) në të cilën është një devijim më i madhë.




Figura 23. Izovijat e vëllimit molar shtesë të sistemit tresh MTBE (1) + n-heksan (2) + cikloheksan (3) në temperaturën 298.15 K; (—) korelimet sipas Cibulkës, (---) modeli asimetrik Hillert^c.

Figura 24 krahason të dhënat eksperimentale të koreluara me ekuacionin e Cibulkës me të dhënat e parashikuara të ngjeshmërisë izentropike shtesë të modeluara me modelin Hillert të tipit c, nga figura shihet se ka një përputhshmëri të mirë në mes të vlerave eksperimentale dhe të modeluara të κ_S^E .




Figura 24. Izovijet e ngjeshmërisë izentropike shtesë të sistemit tresh MTBE (1) + n-heksan (2) + cikloheksan (3) në temperaturën 298.15 K; (—) korelimet sipas Cibulkes, (---) modeli asimetric Hillert^c.

Figura 25 tregon krahasimin në mes të devijimeve të indeksit të thyerjes të fituara me ekuacionin korelues të Cibulkës dhe të vlerave të parashikuara nga modeli simetrik Kohler, nga e cila shihet se nuk ka një përputhshmëri të mirë.




Figura 25. Izovijat e devijimit në indeksit të thyerjes të sistemit tresh MTBE (1) + n-heksan (2) + cikloheksan (3) në temperaturën 298.15 K; (—) korelimet sipas Cibulkes, (---) modeli simetrik Kohler.

MTBE (1) + n-heksan (2) + benzen (4)

